



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.07.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për vitin 2022”, relatore znj. Irena Plaku. (Nuk ka pasur kundërshtime - Shtyrë nga mbledhja plenare e datës 25.06.2024.)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:29 dhe mbaroi në orën 16:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Markelian Koça | (anëtar) |
| 7. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 8. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj.***

Naureda Llagami, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Albens Tabaku* dhe z. *Bledar Bajri*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 2. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 4. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
- 5. Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice (në sallë).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.*
- 7. {...}, gjyqtare (në sallë).*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për vitin 2022”, relatore znj. Irena Plaku. (Nuk ka pasur kundërshtime - Shtyrë nga mbledhja plenare e datës 25.06.2024.)

(Hyn në sallën e mbledhjes gjyqtarja {...}.)

Ilir Rusi: Përshëndetje të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas njoftimit të bërë dhe krijimit të kuorumit të nevojshëm, mbledhjen e deklaroj të hapur.

Për arsye objektive, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor e ka të pamundur për të qenë pjesë e kësaj mbledhjeje. Kështu që mbledhja do të drejtohet nga unë Ilir Rusi, Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas rendit të ditës, në pikën 1 të saj kemi shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për vitin 2022”, për të cilën është përgatitur relacioni nga znj. Plaku. Është për t’u thënë fakti që znj. {...} nuk ka pasur kundërshtime mbi këtë vlerësim etik dhe profesional, por për shkak të shqyrtimit të bërë

2

në mbledhjen e datës 25.06.2024 është shtyrë dhe është vendosur për t'u shqyrtuar sot. Shkaku i shtyrjes ka qenë që znj. {...} si magjistrate të thirret për t'u dëgjuar në lidhje me raportin e vlerësimit përkatës. Me këtë rast edhe gjyqtare {...} është prezent dhe do të doja t'i jepja fjalën nëse ka diçka për të thënë. Theksoj faktin që përgjatë komunikimit të bërë nga relatorja, nuk ka patur kundërshtime. Nëse keni ndonjë opinion apo jo për të thënë, dhe pastaj të kalojmë në një moment të dytë nëse anëtarët prezent kanë pyetje ndaj jush apo jo.

Fjala për ju zonja {...}.

{...}: Atëherë, unë jam gjyqtare {...}, e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Jam njohur me projektraportin. Nuk kam parashtruar ankim për projektraportin. Ju falënderoj për thirrjen në këtë seancë. Fakti që nuk kam parashtruar ankim, në fakt kam pasur mosdakordësimet e mia, nuk kam parashtruar ankim, sepse dihet tashmë ngarkesa e madhe që ne kemi dhe ankimi është shumë impenjativ, domethënë në qoftë se do të ulesh të analizosh një për një të gjithë raportin. Në këtë kontekst, meqenëse më thirrët, do të parashtroja dy mosdakordësi lidhur me raportin. Nëse ka mundësi t'i përmbledh në mënyrë të shkurtër me dy fjalë.

Pjesa kryesore do të thojë, me të cilën nuk jam dakord, është ajo e anës profesionale. Jam gjyqtare nga viti 2000 dhe në vazhdim, deri më sot pranë kësaj gjykate. Mendoj që në anën profesionale është e vërtetë që kemi ato kriteret që përcaktohen vetë me vendime dhe mënyra sesi është organizuar projektraporti në tërësinë e tij, por kjo është më shumë se kaq. Nuk mund të matet aftësia profesionale vetëm me atë që janë pikëzime ose çka janë nënkritere në një raport.

Mendoj që tek pjesa e aftësisë profesionale, veçanërisht dy shtyllat kryesore të saj që janë “Njohuritë ligjore” dhe “Arsyetimi ligjor” do të ndalesha në atë që, është evidentuar në raport shumë qartë që gjykata identifikon qartë natyrën e çështjes; ka aftësi shumë të mira në identifikimin e natyrës së çështjes; ligjin e zbatueshëm në konfliktin e normave; ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit të zbatueshëm; por është vënë theksi në fakte të tilla të cilat mendoj që nuk mund të bëjnë të cënueshëm anën profesionale ose aftësitë profesionale të gjyqtarit. Dhe më konkretisht këto janë prekur ose të themi që janë bërë evidente fakte të tilla të cilat kanë të bëjnë me parashtrime që

kanë të bëjnë me, në pjesën arsyetuese të vendimit thuhet “nuk gjejnë pasqyrim faktet procedurale dhe ecuria procedurale e çështjes”. Mendoj se vendimi gjyqësor në fund të fundit është një ekstrakt i gjithë asaj ecurisë që ka ecur, i gjithë shqyrtimi që ka bërë gjykata dhe hetimit të plotë të saj, dhe në fund do të ndalet në atë gjykata ku ka arritur, me atë ndërgjyqësi, me atë bazë ligjore, me atë shkak ligjor, me ato pretendime të palëve, me ato prova që janë aty dhe mbi të cilën do bëhet analiza. Po të shohim edhe K.Pr.Civile në asnjë moment nuk ka të parashikuar ose të përcaktuar qartësisht që në pretendimin përfundimtar gjykata duhet t’i kthehet edhe një herë analizës së fakteve procedurale. Faktet procedurale të cilat kanë të bëjnë të tilla me kompetencën, juridiksionin, ndërgjyqësia, rregullimi i objektit të padisë, etj., janë marrë në analizë, janë shqyrtuar nga gjykata, ndodhen qartësisht të pasqyruara në dosjen gjyqësore dhe janë evidente nga subjekti që ushtron kontroll mbi të. Pra në momentin që ushtrohet kontroll mbi gjyqtarin në aftësitë profesionale të gjyqtarit, merret dhe shikohet dosja në kompleksitetin e saj, shikohen të gjitha veprimet procedurale që ka ndjekur, të gjithë arsyetimet që ka bërë gjykata, analiza që kanë marrë, të gjitha faktet procedurale që gjejnë në vendim dhe janë të arsyetuara në vendimmarrjen e gjykatës dhe të pasqyruara qartësisht në procesverbalin gjyqësor. Mendoj që është e padrejtë dhe e pavend që mund të penalizohet gjyqtari pse në vendimin përfundimtar gjyqtari nuk ka analizuar fakte procedurale.

Do të përmendja shkurtimisht vetëm një fakt, pa analizuar në të tjerat. Në një moment të caktuar, në një vendim, mua më ka ardhur kompetencë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë dhe ajo gjykatë ka bërë analizën përse nuk është kompetente dhe pse kompetente është gjykata civile. Në raport thuhet që gjykata dhe pse ka parashtruar këtë rrethanë, pra ka pasqyruar pse gjykata ose momentin kur Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka cituar pse nuk është kompetente dhe ia dërgon gjykatës civile, thuhet që kjo gjykatë nuk ka marrë në analizë dhe nuk ka arsyetuar më tej pse është kompetente gjykata civile. Mendoj që një moment të tillë (ky është një fakt vetëm për ilustrim), mendoj që nuk ka vend për një interpretim të tillë, pasi në qoftë se unë do të kisha një mendim tjetër nga ajo gjykatë që ka sjellë çështjen për kompetente, kjo do kishte gjetur pasqyrim me një konflikt kompetencash, që unë do ta kisha dërguar në gjykatën kompetente, dhe nuk është me vend që unë të kthehem dhe mbas një kohe tashmë kur çështja ka kaluar mbas nja 1 vit, mbas nja 2 vitesh shqyrtime, unë të marr

dhe të analizojë përsëri faktin pse unë si gjykatë jam kompetente në pikëpamje të kompetencës lëndore.

Faktet procedurale gjejnë pasqyrim të qartë, të plotë në të gjithë dosjen gjyqësore sepse dosja gjyqësore nuk është vetëm vendim përfundimtar. Vendim përfundimtar është ekstrakti, çka ne kemi arritur së fundmi dhe nuk ka nevojë që të analizojmë përsëri të gjithë këto fakte, kur ato pasqyrohen qartësisht në dosje dhe shikohet evidente nga subjekti që ka ushtruar kontroll mbi atë dosje.

Një moment tjetër ishte edhe faktet e themelit. Faktet e themelit, thuhet që gjyqtari nuk pasqyron faktet e themelit në pjesën hyrëse të pjesës përshkuese dhe arsyetuese të vendimit. Në asnjë moment, po të shohim edhe ligjin procedural, ose po të shohim edhe strukturat e vendimeve, duke vënë theksin qartë në faktin që nuk kemi një strukturë të unifikuar dhe kjo nuk është kot. Nuk themi që në vite gjyqtarët ose gjykata, ose ligji, nuk mund të unifikonte strukturën e vendimit. Por kjo ka të bëjë pikërisht me faktin se ajo është një punë individuale e pavarur e gjyqtarit. Gjyqtari rri, e mendon qartë atë çfarë do hedhë në vendim; si do ta strukturojë vendimin, dhe e rëndësishme është që të përcillen tek palët, si dhe tek një i tretë që e merr vendimin, të përcillen këto gjëra, të përcillet që faktet e çështjes, faktet dhe rrethanat e çështjes aty janë pasqyruar, provat janë pasqyruar. Ligji material dhe dispozitat mbi të cilat mbështetet mendimi janë të pasqyruara; është bërë analizë e tyre dhe në fund të fundit gjykata në vijim ka konkluduar mbi atë analizë dhe mbi vendimmarrjen e saj, duke arsyetuar dhe vendimin.

Thënë kjo, nëse këto fakte do të gjejnë pasqyrim në mënyrë të pavarur, faktet e themelit do të gjenin pasqyrim të pavarur në pjesën hyrëse të vendimit apo në pjesën e analizës juridike, për mua kjo nuk mund të cenohet ana profesionale e gjyqtarit, sepse nuk tregojnë që ky gjyqtar nuk ka aftësi profesionale. Gjyqtari mund të paraqesë këto fakte në mënyrë të detajuar në pjesën e parë, mund t'i paraqesë në pjesën e analizës. Ndoshta kjo për mua do të bënte një rënie në përsëritje dhe mund të sillte, shkruan një herë faktet në pjesën hyrëse dhe pastaj shkruaj edhe një herë faktet gjatë analizës. E rëndësishme është ajo që përcakton edhe ligji procedural, më konkretisht neni 310 i K.Pr.Civile dhe vendimet në përgjithësi të gjykatës; pasqyrohet fakti, pasqyrohet analiza, pasqyrohet prova, pasqyrohet ligji. Nëse këto të gjitha dalin qartë, nëse pretendimeve të

palëve iu është dhënë qartë një përgjigje në vendim, mendoj që kjo nuk mund ta bënte të cenueshme në asnjë moment anën profesionale të gjyqtarit.

Nga ana tjetër thuhet që pretendimet e palëve jepen të detajuara. Pretendimet e palëve shumë shpesh jepen të detajuara në proces dhe kjo pikërisht ka cenuar edhe pjesën tjetër “Arsyetimi ligjor”, nënkriterin tjetër, përveç “Njohurive ligjore”, nënkriterin tjetër që është “Arsyetimi ligjor”. Ky fakt ka qenë penalizues edhe në këtë nënkriter tjetër.

Duhet të theksojmë një fakt që në asnjë moment ligji procedural nuk pengon që ne të themi faktet dhe pretendimet e palëve të arsyetuara në mënyrë të detajuar apo jo. Për mua në çmuarjen time si gjykatë, unë çmoj që kjo pjesë e pretendimeve të palëve është qartësisht e dallueshme nga pjesa tjetër e analizës dhe e arsyetimit që unë kam bërë në vendim. Nëse do të shikojë vetë pala ose vjen një subjekt i tretë që do të analizojë vetë vendimin, nuk ka asgjë të keqe që nga njëra anë të marrë dhe të balancojë atë çka pala ka pretenduar, atë çka pala ka thënë, duke përfshirë faktin, duke përfshirë ligjin, duke përfshirë provën dhe ky pastaj të gjejë pasqyrimin e tij të qartë dhe në pjesën arsyetuese të gjykatës. Në këtë kontekst mendoj që paraqitja e detajuar e pretendimeve të palës, në asnjë moment nuk mund të bëjë të cenueshëm aftësinë time profesionale derisa të vijë ai pikëzim ose të vijë ajo shkallë vlerësimi e cila është një shkallë vlerësimi shumë e mirë.

Mendoj që edhe në radhën e parë, edhe në raportin e parë, kjo pjesa profesionale (nuk kam dakordësuar shumë edhe në atë moment), megjithatë sikurse edhe në raportin e parë, nuk kam bërë ankim, por duke menduar që tashmë më duket absolutisht e padrejtë që mbas 10 viteve (raporti i parë është 2013-2016 dhe është një periudhë pothuajse 9 vite në vitin 2022 që bëhet raporti tjetër) unë të dalë me një aftësi profesionale dhe më të ulët sesa ajo që unë kam pasur për një periudhë rreth 7-vjeçare a 9-vjeçare më përpara, ndërkohë që Gjykata e Tiranës përballet, siç e dini shumë mirë, përballet me një kategori shumë të gjerë çështjesh, me shkallë niveli të vështirë, edhe të gjitha këto sigurisht që e rrisin profesionalisht gjyqtarin dhe nuk mund të mendohet që gjyqtari i Gjykatës së Tiranës me një ngarkesë të tillë të bëjë regres mbrapa dhe të kthehet nga 90 pikë në vlerësimin e parë, të kthehet në 70 pikë në vlerësimin e dytë.

Tek “Arsyetimi ligjor” që është momenti tjetër, që unë do them edhe aty dy fjalë, thuhet “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”, dhe vihet theksi pra tek pretendimet e palëve (që unë i citova më lart), vihet theksi tek rregullat gramatikore.

Ndoshta e kam unë gabim, ndoshta nuk jam në dijeni të këtij fakti, nuk e di nëse vendimi i nënshtrohet një specialisti të fushës së gjuhës (do tërhiqesha nëse do të ishte kjo). Mendoj që kam qenë, ne kemi bërë të gjithë gjuhë shqipe dhe mendoj që kam qenë shumë mirë në gjuhën shqipe dhe sot mendoj që kam aftësi shumë të mira në gjuhën shqipe, në mënyrën se si unë ndërtoj fjalitë ose mënyrën se si respektoj rregullat procedurale, si ato të sintaksës dhe të morfologjisë, në konceptin e përgjithshëm të gjuhës, megjithatë thashë tërhiqem sepse në qoftë se do vihen në balancë një subjekt, ai që ushtron kontrollin, me subjektin që i nënshtrohet kontrollit, të dy jashtë sferës së gjuhës, domethënë të dy nuk jemi specialistë të gjuhës, atëherë mendoj që kjo ka elemente subjektivizmi brenda sepse gjithsecili e shikon mënyrën e pikëzimit ose mënyrën e trajtimit ose të fjalisë, të formulimit të fjalisë, duhet ta shikojmë pak të diferencuar, dhe kjo them, në këtë kontekst them që edhe kjo, pavarësisht se janë në zëra (nënkritere), nuk mendoj që kjo mund të penalizojë gjyqtarin dhe të themi... thashë për sa kohë do tërhiqesha në qoftë se kjo do t'i ishte nënshtuar një specialisti të fushës së gjuhës dhe ai do vinte dhe do thoshte, po, ky gjyqtar ka problematikë me pikëzimet, ka problematikë me shenjat, ka problematikë me gramatikën, etj.

Thuhet që citohen vendimet e Gjykatës së Lartë. Është e vërtetë që i kam cituar vendimet e Gjykatës së Lartë. Në një moment mund të mendohet që gjyqtari po themi vetëm po e citon numrin e vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë. Bëhet një citim i gjatë, thuhet në raport, nga ana e gjyqtarit, e vendimeve të Gjykatës së Lartë. Citimi i gjatë në ato momente ka të bëjë me faktin kur kam dashur të bëj evidente atë situatë për të cilën unë e kam cituar atë vendim të Gjykatës së Lartë. Pra, që kur një subjekt i tretë, qoftë pala, qoftë një subjekt i tretë, të marri të analizojë atë vendimin, duke lexuar në mënyrë pak më të hollësishme edhe vendimin e Gjykatës së Lartë kupton atë çka unë kam dashur që të përcjell në atë vendim, siç mund të jetë shkak i padisë kur unë kam hyrë dhe kam bërë vetë analizën e shkakut të padisë, pavarësisht pretendimeve ose parashtrimeve që kanë bërë palët apo siç mund të jenë elemente të tjera të cilat kanë të bëjnë me ligjin material dhe ligjin procedural.

Thuhet bihet në përsëritje. Nëse kam rënë në përsëritje, ajo ka qenë në funksion të asaj çka unë kam dashur të përcjell dhe duke cituar paragrafë të ndryshme ndoshta të vendimeve unifikuese.

Për sa i përket strukturës së vendimit. Sikurse e thashë edhe më parë, nuk kemi një strukturë të unifikuar sepse gjyqtari nuk mund të futet brenda një kornize, puna e gjyqtarit është më shumë se sa një kornizë. Mendoj që të gjitha vendimet e mia kanë një metodologji, pra pasqyron pak një pjesë hyrëse për të përshkruar në mënyrë ose në disa raste nuk përshkruaj për shkak të analizës që bëj më tej në pjesën arsyetuese timen. Jepen pretendimet e palëve. Në çdo moment jepet arsyetimi i detajuar dhe i hollësishëm i gjykatës ku merren në mënyrë të detajuar të gjitha pretendimet e palëve, faktet, provat, ligji, për të dhënë pastaj edhe konkluzionin në mbështetje të asaj çka gjykata ka arritur në vendimmarrjen e saj.

Këto ishin për sa i përket pjesës profesionale, në mënyrë të përgjithshme sepse thashë unë nuk kam bërë ankim dhe unë nuk mund të hyjë tani në mënyrë të detajuar dhe për të mos ju marrë juve kohë.

Për sa i përket pjesës organizative, aftësive organizative, është e lehtë të themi sot sepse janë ato kritere apo nënndarje që diktojnë në pikëzim në pjesën organizative, por duhet të kemi parasysh që Gjykata e Tiranës në vitin 2022 është përballur me një pamundësi, jo thjesht një pamundësi, por një pamundësi absolute, për të mbajtur në kontroll të plotë pjesën organizative. Unë them, ajo çka duhet të përcillej është ajo, sa e impenjuar jam unë si gjyqtare për të mundësuar dhe për të arritur të shqyrtojë brenda kohës. Nuk mund të ndalemi vetëm thjesht në numra. Nuk u bënë brenda afateve. Nuk u bënë brenda afateve, është e vërtetë që nuk janë bërë brenda afateve. Nuk mund të bëhen brenda afateve. Tek ne edhe 6 muaj nuk i gjen palët në Tiranë, jo më të arrish brenda 6 muajve të mbarosh çështjen. Ama impenjimi ka qenë impenjim maksimal. Mos harrojmë që horizontalisht, në plan horizontal ne kemi pasur në 2022 mbi 2000 çështje në gjykim. Unë kam mbaruar mbi 1000 çështje, 1200 çështje. Është e pamundur që të ushtrtojë gjyqtari një kontroll të plotë mbi një sasi të madhe çështjesh edhe me gjithë impenjimin 24 orë të tij. Mos harrojmë që ne bëjmë mbi 10 seanca në ditë, mbi 12 seanca në ditë; ne marrim vendimet i analizojmë mbas përfundimit të ditës mbi kohën e plotë që është e zënë nga ana jonë. Në këtë kontekst duhej parë edhe kjo aftësia organizative. Mos i faturohen gjyqtarit ato që një gjyqtar në kushte normale duhet t'i kishte shumë më të thjeshta.

Shtyhet seanca, thuhet diku, për shkak të tej zgjatjes së afatit. Po, shtyhet seanca, se kur unë lë 10 – 12 çështje në ditë, unë nuk mund të planifikoj që këtë gjyq tashmë ta vazhdoj edhe pas orarit që kam planifikuar dhe pastaj çfarë do të bëhet me proceset e tjera.

Kështu që për këtë pjesën organizative unë nuk kam se çfarë të them më tej por gjithsecili nga ju e ka shumë të qartë dhe është shumë evidente se çfarë ndodh me Gjykatën e Tiranës në 2022 dhe nuk kam se çfarë të shtoj asnjë pjesë tjetër në këtë pikë.

Pjesa tjetër që do ndalesha është tek angazhimi profesional. Edhe kjo është pak shqetësuese, në kuptimin e kësaj që, unë e kam ngritur edhe në analizën që kemi bërë, analizën vjetore të gjykatës. Kanë qenë prezent edhe anëtarë të KLGJ-së, kohë më para, ndoshta në 21-shin (nuk e mbaj mend tani 21-shin apo 22-shin). Ne na njoftoheshin tematikat nga magjistratura, na vinte vetëm tematika fillimisht dhe pastaj na vinin datat, e cila pamundësonte programimin e tyre. Duhet të kemi parasysh që ne seancat i kemi lënë një herë në katër muaj, pesë muaj, gjashtë muaj arrinte. Atëherë, në momentin që unë nuk i kam datat, unë kam zgjedhur më mirë që të vazhdoj atë proces të cilin atij, subjektit, palës, ia kam lënë për gjashtë muaj, sesa unë të shkoj në një trajnim në Shkollën e Magjistraturës, thashë, dhe kjo e gjitha për shkak të kushteve të jashtëzakonshme në të cilat ne kemi qenë. Megjithatë i kam marrë të gjitha masat që në gjysmën e dytë të 2022 të planifikoja të paktën atë minimalen që kërkohet (5-ditorëshin) sepse pjesa tjetër ka qenë absolutisht e pamundur. Unë e kam reflektuar edhe tek vetëvlerësimi që kam bërë, kam reflektuar faktin që një nga ditët 5-ditorëshe, meqenëse ajo më ka penalizuar, nuk u bë nga Shkolla e Magjistraturës. Seminari i fundit ka qenë seminari i dhjetorit, data 19 dhe 20 dhjetor, ku data e dytë është anuluar nga Shkolla e Magjistraturës. Kanë qenë vetëm dy seminare të tjera, dy seminare penale. Atëherë mund të zgjidhja të shkoja në këto seminare penale për të bërë formalisht atë 5-ditëshin, por nuk e kam parë të arsyeshme dhe me vend për sa unë nuk merrem fare me penalet, të shkojë të marrë pjesë në një seminar vetëm për të bërë formalisht ato ditët. Thashë ka qenë fundi i 2020, i 2022 më falni. Kështu që kjo nuk ka ardhur pra për shkakun tim, ka ardhur për vetë ato pamundësitë e Shkollës së Magjistraturës, për të mundësuar seminarin 2-ditore që kanë qenë.

Këto do të ishin evidente që unë kam në parim mosdakordësi, por thashë, theksoj edhe një herë dhe vë theksin kryesor tek pjesa e aftësisë profesionale. Nuk e gjej veten në mënyrë kategorike në atë vlerësim që kam marrë për pjesën e aftësisë profesionale. Nuk mendoj që më përgjigjet dhe nuk mendoj që argumentet që më kanë cenuar për pjesën profesionale kanë të bëjnë thjeshtë me mënyrën se si unë parashtroj në vendim faktet apo nuk parashtroj faktet procedurale të cilat vetë ligji procedural nuk i kërkon.

Faleminderit!

Në qoftë se keni ndonjë pyetje. Nuk kam gjë tjetër për të shtuar.

Ilir Rusi: Faleminderit për shpjegimin e dhënë.

Ftoj anëtarët nëse kanë ndonjë pyetje.

Po, zoti Kurushi.

Klodian Kurushi: Përshëndetje zonja {...}!

{...}: Përshëndetje!

Klodian Kurushi: Unë kam vetëm një pyetje, për të sqaruar ndoshta edhe një pretendim që ngriti një nga kolegët tanë, i cili nuk është aktualisht sot në mbledhje, z. {...}, pretendim që lidhej me, po të shikojmë pjesën e fundit, pra pjesa e trajnimeve në Shkollën e Magjistraturës. Ju e thatë sot, e keni thënë edhe është pasqyruar në raport, është pasqyruar fakti që ju keni aplikuar për 5 ditë në vit dhe në bindjen tuaj ato 5 ditë të cilat janë njoftuar nga Shkolla e Magjistraturës ju do t'i përmbushnit në kohë, na rezulton sipas shpjegimeve që keni dhënë dhe sipas informacioneve që kemi marrë nga Shkolla e Magjistraturës, një trajnim i cili ishte i planifikuar në dy ditë, ndryshoi dhe u bë në një ditë. Ajo çfarë na ngrinte si dyshim paraprakisht ishte fakti nëse Shkolla e Magjistraturës ju ka njoftuar dhe ka rezultuar që ju ka njoftuar, pra nga dy ditë është bërë një ditë trajnimi, por do donim të dinim në çfarë kohe ju ka njoftuar? Brenda muajit dhjetor.

{...}: Brenda asaj kohe. Në atë kohë që shkuam, që seminari për nesër nuk do zhvillohet.

Jo paraprakisht.

Edhe një gjë tjetër. Më fal, të lutem.

Edhe nëse unë do të isha njoftuar, supozojmë një muaj përpara, nuk kishte më seminare. Dy seminare kanë qenë vijues, vetëm penale. Më kupton? Edhe në qoftë se kjo di ishte bërë disa ditë përpara, sepse ky planifikim, e thashë edhe një herë, është shumë i vështirë. Mezi janë gjetur koha, data dhe përshtatja. Më kupton? Ishte pamundësi reale objektive për të marrë pjesë në një seminar tjetër, veç të shkoja në penale.

Klodian Kurushi: Që të sqarojmë këtë pjesën.

Ju jeni gjendur para një fakti të kryer. Në momentin që keni shkuar për t'u trajnuar për dy ditë trajnimi, atë ditë Shkolla e Magjistraturës ka thënë: "Dy ditët e trajnimit do t'i bëjmë në një ditë". Jam i qartë për këtë pjesën?

{...}: Po!

Klodian Kurushi: Pra 2-ditorëshi i planifikuar do bëhet në një ditë. Dhe ky njoftim i ndryshimit të axhendës është bërë ditën që keni shkuar ju.

{...}: Nuk mbaj mend që të jemi njoftuar.

Klodian Kurushi: Mirë, faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. Kurushi!

Faleminderit magjistrate {...}!

Ka pyetje të tjera?

Keni pyetje të tjera të nderuar anëtarë?

(Nuk ka pyetje.)

Meqenëse nuk ka pyetje të tjera, ftoj zonjën magjistrate {...}, nëse s'ka diçka tjetër për të shtuar, të vazhdojë, me qëllim që Këshilli të procedojë me procedurën përkatëse.

(Del nga salla e mbledhjes gjyqtarja znj. {...}.)

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj procedure, fjala është kërkuar nga relatorja zonja Plaku.

Irena Plaku: Përshëndetje!

Atëherë, pasi dëgjova edhe gjyqtaren në shpjegimet e dhëna në seancë, në kushtet kur kjo e fundit nuk paraqiti kundërshtime brenda afatit të parashikuar, unë duhet të saktësoj që, duhet të jap pak sqarime për anëtarët, megjithëse janë njohur me projektraportin e vlerësimit i cili i është bërë me dije të gjithë anëtarëve. Në fakt u duk... gjyqtarja kishte një lloj kështu sikur është vlerësuar shumë ulët, është vlerësuar shumë mirë, me 87 pikë. Janë evidentuar disa problematika të hasura, kur për pjesën e parë konkretisht për treguesin “Njohuritë ligjore”, ashtu siç është bërë edhe tek raporti i parë i vlerësimit për periudhën 2013-2016, ku është konstatuar e njëjta problematikë, është konstatuar që gjyqtarja nuk i evidenton rrethanat e faktit, por e nis arsyetimin me paraqitjen e pretendimeve të palëve dhe më pas fillon me analizën juridike. Gjyqtarja tha që struktura nuk është e përcaktuar në ligj. Në fakt, neni 310 i K.Pr.Civile përcakton që një nga pjesa përshkruese-arsyetuese duhet të përmbajë, po e lexoj shprehimisht pikën e dytë të nenit 310 ku thotë: Në pjesën përshkruese duhet të përmenden: rrethanat e çështjes ashtu siç janë konstatuar gjatë gjykimit dhe përfundimi i nxjerrë nga gjykata; provat dhe arsyet mbi të cilat mbështetet vendimi; dispozitat ligjore mbi të cilat bazohet vendimi. Kjo është pjesa përshkruese. Pra pjesa përshkruese përmban rrethanat e faktit. Gjyqtarja konstatohet që nuk i parashtron ato siç kanë rezultuar nga hetimi por parashtron vetëm pretendimet e palëve. Evidentohen edhe disa raste të cilat unë i kam evidentuar në fakt, që mungon procedura, por nuk i është ulur pikëzimi për këtë rast. Janë evidentuar disa problematika në fakt sepse shikohej që në vendime në disa raste pasqyronin dhe në disa raste jo. Për shembull pse është vlerësuar një rrethanë e tillë? Nuk parashikohej që gjatë vendimmarrjes apo gjatë procedurës në vendimmarrje ishte marrë në shqyrtim masa e sigurimit të padisë. Në fund konstatohej, por pa arsyetuar kjo pjesë, që ishte vendosur ligjërimi i masës. Kështu që ky vendim ngelte i paqartë për një të tretë dhe për këtë e kam theksuar, që jo në të gjitha rastet evidentohet procedura.

12

Dua të sqaroj që ne asnjëherë nuk i kemi ulur pikëzimit gjyqtarës për mënyrën e strukturimit të vendimit nga pjesa e mosshkruajtjes apo mospërshkrimit të procedurës, përkundrazi. Në rast se pjesët përbërëse të vendimit, rrethanat e faktit janë përshkruar qartë, janë përshkruar që në pjesën e fillimit të vendimit, kjo ka rëndësi dhe është vlerësuar maksimalisht. Unë kam vlerësuar që gjyqtarja ka një vlerësim “shumë mirë” por nuk është në atë nivel që të jetë “shkëlqyeshëm” për sa kohë që ka këtë mungesë tek pjesa e pasqyrimin të rrethanave të faktit.

Gjithashtu i është ulur pikëzimi me një nivel tek, në fakt këtu është me dy nivele, “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimeve”. Këtu ka të bëjë me faktin e mosrespektimit të rregullave gramatikore. Një ndër nivelet është ulur për këtë arsye. Gjyqtarja tha që këtu duhet të jetë një gjuhëtar që ta vlerësojë. Në fakt vendimi i drejtohet një lexuesi të zakonshëm dhe qëllimi i vendimmarrjes është qëllimi i një vendimi të mirë sepse kur vlerësohet maksimalisht për secilin tregues, është që vendimi të jetë i atillë, që të evidentohet në krahasim me vendimet e tjera, dhe duhet të jetë i shkëlqyeshëm. Në këtë rast unë kam konstatuar mangësi për sa i përket respektimit të rregullave gramatikore.

Gjyqtarja thjesht tha që kush e ka vlerësuar këtë.

Këtë e vlerëson Këshilli apo edhe një anëtar, e cila është e përcaktuar në ligj, dhe është normalisht një lexues i thjeshtë, nuk ka nevojë që të jetë gjuhëtar apo jurist i shkëlqyer. Gjithashtu për këtë tregues i është ulur edhe për faktin se gjyqtarja shkonte shpeshherë në përsëritje. Pasqyronte pretendimet e palëve në mënyrë tepër të detajuar. Nuk i është ulur për këtë fakt. Por konstatohet që këto pretendime të palëve si dhe vendimet unifikuese, përveçse sqaroheshin edhe një herë, në paragrafë të mëvonshëm të vendimit përsëriteshin, kishte pjesë të përsëritura dhe vendimi shkonte.. domethënë nuk ishte i qartë dhe i lodhshëm, duke shkuar shpeshherë në përsëritje. Dhe për këtë është ulur edhe pikëzimi.

Ndërsa për treguesit e tjerë, është ulur edhe për strukturën, për mënyrën e strukturimit të vendimit. Konstatohej përveçse pjesës së paraqitjes që nuk mungonte, absolutisht nuk i është ulur për këtë gjë, por konstatohej që paragrafët nuk kishin lidhje logjike me njëra-tjetrën. I është ulur me sa mbaj mend edhe tek pjesa e pasqyrimin të

shpenzimeve gjyqësore, që nuk ishte e qartë për pjesën se në ç'masë i ngarkoheshin palët, dhe për këtë është mbajtur edhe një standard tek gjyqtarët e tjerë.

Për pjesën organizative gjyqtarja pretendoi që nuk ishte dakord. Megjithëse nuk kishte asnjë kundërshtim, unë do të relatoja që për të gjitha këto “koha mesatare” “afati ligjor” është me afatin minimal që shkonte edhe me 1 pikë, 2 pikë. Janë rritur nga tre nivele për shkak të ngarkesës së gjyqtarës. Të gjitha ia kam rritur me 3 nivele, por ka arritur në atë gjendje që nuk mund të shkonte.

Ndërsa sa i përket kriterit të katërt, konkretisht “Aftësia personale dhe angazhimi profesional”, unë e kam relatuar shumë mirë, shumë qartë besoj, se nuk po them shumë mirë, shumë qartë në projektraport, që gjyqtarja ka qenë pjesëmarrëse në katër trajnime në katër ditë. Provohet fakti që një trajnim është anuluar nga ana e Shkollës së Magjistraturës, por kam thënë edhe ndër të tjera që nuk provohet që gjyqtarja ka pasur mundësi për të marrë pjesë në seminare të tjera. Vetë gjyqtarja sot tha që, po, nuk ka marrë pjesë sepse një seminar i cili ishte planifikuar për natyrën civile, ishte anuluar, por se kishte pasur edhe dy mundësi të tjera për të qenë prezent, por nuk i kishte zgjedhur të ishte prezent për sa kohë që nuk ishin pjesë e natyrës së saj të gjykimit apo të angazhimit profesional që është vetëm në fushën civile.

Kështu që unë i qëndroj të njëjtave propozime të cilat kam paraqitur në projektraport.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Ftoj anëtarët e tjerë nëse kanë diskutime apo propozime.

Po, zoti Kurushi!

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Shkurtimisht pa ju hëngër shumë kohë, unë i qëndroj propozimeve që kam dhënë edhe mbledhjen e parë, në mbledhjen e parë pasi u dëgjua relacioni. Aq më tepër kur dëgjova edhe shpjegimet që dha zonja {...}. Vazhdoj të jem edhe më i bindur me ato propozimet që kam bërë. Zonja {...}, sidomos për kriterin e fundit të vlerësimit, pra qenien, duke ndjekur afatin 5-ditor në programin e trajnimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës, zonja {...} ka qenë e planifikuar, ka pasur planifikime, ka bërë

14

planifikimet për të qenë në 5 të tilla, pra për të plotësuar afatin minimal të parashikuar nga rregullorja dhe metodologjia e vlerësimit/të pikëzimit të kandidatëve. U konfirmua edhe fakti që ditën e fundit, pra që ditën e paraqitjes i erdhi njoftimi për të ndryshuar axhendën, pra nga dy ditë të bëhej një ditë. Kështu që fakti i mospërmbushjes së detyrimit prej 5 ditësh nuk rrjedh nga mosdëshira, nga mosshkuarja, mosinteresimi i zonjës {...} për të qenë e pranishme në këtë trajnim, por ka ardhur si rezultat i ndryshimit të axhendës bërë nga Shkolla e Magjistraturës dhe ky ndryshim i axhendës nuk duhet të penalizojë apo të vërë në vështirësi kandidaten në procesin e vlerësimit për ndjekjen e trajnimeve të çdo kandidati që ka për detyrim për të ndjekur në Shkollën e Magjistraturës.

Kështu që unë i qëndroj atyre propozimeve të mia. Konkretisht jam për dy tregues. Është “Aftësia për të njohur ligjin” nga 20 në 25. “Aftësia për të identifikuar çështjet”.

Ilir Rusi: Po zoti Kurushi, ju lutem perifrizoni propozimet.

Klodian Kurushi: Atëherë, edhe një herë.

Atëherë, më falni, për t’i perifrazuat edhe një herë.

Atëherë, shkurtimisht, për t’i perifrazuat edhe një herë.

Tek treguesit “njohuritë ligjore”, A.a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe ose konfliktin e normave, unë propozoj nga 20 pikë që ka propozuar relatorja, në 25 pikë. Kjo është e para.

Ndërsa e dyta, në treguesin “C” “Gatishmëria e gjyqtares për t’u angazhuar në veprimtari profesionale”, C.a. Pjesëmarrja e gjyqtares në programin e formimit vazhduar në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale, siç e thashë, nga 4 pikë që ka propozuar relatorja, unë propozoj që në këtë rast kandidatja të marrë pikët maksimale, duke i shtuar edhe 16 pikë, pra të shkojë në 20 pikë.

Këto janë dy propozimet e mia.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Po, zoti Hado!

Ridvan Hado: Bashkohem me propozimet e zotit Kurushi.

Tej asaj, tek kriteri i parë, tek nënkriteri “Arsyetimi ligjor” “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” propozoj që nga 9 pikë, të vlerësohet në shkallën maksimale 15 pikë (t’i shtohen 6 pikë).

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hado!

Po zonja Muçi, fjala për ju!

Emona Muçi: Meqenëse jemi në vazhdën e propozimeve për ngritje pikësh në lidhje me strukturën e qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, unë kam mendimin që të vlerësohet me 10 pikë, pra jo mbi mesatare por shumë më lart.

Ndërkohë, në lidhje me momentin e pjesëmarrjes në trajnime, duke iu referuar ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, pika 3 e nenit 5, parashikohet si më poshtë: Periudha e formimit vazhdues duhet të jetë jo më pak se 5 ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë 5 viteve. Dhe më pas vijon me pikën “b” – jo më shumë se 40 ditë në vit dhe jo më shumë se 200 ditë gjatë 5 viteve. Pra kjo dispozitë përcakton se gjatë një viti kalendarik, gjyqtari duhet të marrë pjesë në trajnime vazhduese jo më pak se 5 ditë (e ka ligji).

Në metodologjinë e vlerësimit, lidhur me këtë tregues përcaktohet se, në lidhje me pikëzimin e aftësisë së gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera, treguesi i pjesëmarrjes në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës matet duke u bazuar me informacionin me shkrim që përcjell Shkolla e Magjistraturës i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e magjistratëve në trajnime. Pjesëmarrja e magjistratëve në trajnime të tjera vlerësohet bazuar në dokumente dhe thotë Këshilli e konsideron vlerë të shtuar pikërisht plotësimin, jo vetëm plotësimin e minimumit 5-ditor si vlerë e shtuar, por aftësinë që ka fituar magjistrati, jo në teori, por në praktikë, me angazhimin dhe me ndërveprimin me magjistratë të tjerë dhe për këtë arsye unë nuk mbështes propozuesin z. Kurushi, pikërisht duke iu referuar interpretimit germë për germë të ligjit dhe interpretimit të barabartë për të gjithë magjistratët të cilët janë vlerësuar në interpretimin si më poshtë. Faleminderit!

Irena Plaku: Kam të drejtën e fjalës.
Mund të marr të drejtën e fjalës të lutem?

Ilir Rusi: Tani, e drejta e fjalës është, por ju lutem të jini konciz.

Irena Plaku: Patjetër që jam shumë koncize.

Ilir Rusi: E di pse të jeni konciz?
Siç është edhe vetë vlerësimi konciz.

Irena Plaku: Patjetër.

Vetëm vlerësimi që s'është konciz, se është shumë i detajuar.
Atëherë, sqaroj anëtarët, konstatoj që po ngrihet një pikëzim maksimal tek treguesi "Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit", kur për të njëjtën gjyqtare, për të njëjtat shkaqe, nga anëtarët është vlerësuar me nivel tjetër. Gjithsesi, sa për ta sqaruar sepse keni votuar një herë për të njëjtat gjëra edhe tek pjesa e parë.

Ilir Rusi: Atëherë, ju falënderoj kolegë për këto diskutime.

Njëkohësisht edhe magjistratë {...} kishte objeksionet e veta, të cilat u pasuan me diskutime. Dhe në fund konkluduar sipas procedurës, me propozimet përkatëse të bëra nga anëtarët.

Sipas radhës së bërë nga propozimet, do fillojmë me votimin e propozimeve.

Fillimisht është bërë propozimi nga zoti Kurushi, që ka të bëjë me "Aftësitë profesionale të gjyqtarës", A.a. "Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave", nga relatorja është propozuar 20 pikë, zoti Kurushi propozoi që vlerësimi të jetë maksimal me 25 pikë, duke i shtuar 5 pikë.

Irena Plaku: Kundër.

Gentiana Muçaj: Pro.

Ridvan Hado: Pro.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Pro.

(Dëgjohet vetëm germa e parë “P”, pastaj mbyllet mikrofoni.)

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

(Miratohet me shumicë votash.)

Ilir Rusi: Vazhdojmë me propozimin e dytë të zotit Kurushi i cili përgjatë diskutimeve u mbështet edhe nga një anëtar tjetër, z. Hado, që ka të bëjë me pikën 4 “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, tek C.a. “Pjesëmarrja e gjyqtarës në programet e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale”, nga relatorja është propozuar vlerësimi 4 pikë, nga anëtari propozues është propozuar vlerësimi në 20 pikë, duke i shtuar 16 pikë.

Irena Plaku: Kundër.

Gentiana Muçaj: Kundër.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Emona Muçi: Kundër.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord me rritjen e pikëve.

(Miratohet me shumicë votash.)

Ilir Rusi: Vazhdojmë me propozimin e tretë nga zoti Hado që ka të bëjë me “Aftësia profesionale e gjyqtarës”, “Arsyetimi ligjor”, “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”. Relatorja ka propozuar 9 pikë. Zoti Hado propozon vlerësimin maksimal në 15 pikë. Pra me një shtesë prej 6 pikëve.

Irena Plaku: Kundër.

Gentiana Muçaj: Kundër.

Ridvan Hado: Dakord

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Kundër.

Klodian Kurushi: Kundër.

Ilir Rusi: Dakord.

(Miratohet me shumicë votash.)

Ilir Rusi: Vazhdojmë me propozimin e katërt e bërë nga anëtarja znj. Muçi, që ka të bëjë me “Aftësitë profesionale të gjyqtarës”, B.b. “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit”, propozohet nga 8 pikë që e kishte relatorja, në 10 pikë, me një shtesë prej 2 pikëve.

Irena Plaku: Kundër.

Gentiana Muçaj: Kundër.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Nuk dëgjohet vota

(propozimi për rritjen e pikëve ishte i zonjës Muçi.)

Klodian Kurushi: Kundër.

Ilir Rusi: Dakord.

(Miratohet me shumicë votash.)

Ilir Rusi: Të nderuar kolegë, sipas rezultateve të votimit, rezulton që në pikën A. Aftësia profesionale, vlerësimi nga 87 pikë është 100 pikë. Pra nga niveli “Shumë mirë” është "Shkëlqyeshëm". Aftësia organizative është "Shkëlqyeshëm", 90 pikë (siç ishte). Pika C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, 100 pikë, "Shkëlqyeshëm". Ndërsa pika D. Aftësia personale dhe angazhimi profesional, për shkak të votimit, vlerësimi nga 77 pikë, kalon në 93 pikë dhe nga "Shumë mirë" në "Shkëlqyeshëm". Niveli i përgjithshëm i vlerësimit, totali i pikëve është 383, "Shkëlqyeshëm".

Kalojmë në votimin e projekt-aktit të përditësuar sipas rezultateve të dala nga miratimi i propozimeve të bëra nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor prezent në mbledhjen e ditës së sotme datë 30.07.2024.

Irena Plaku: Atëherë jam kundër votimit të projektraportit ashtu siç vlerësova deri më tani, duke i qëndruar vlerësimit me "Shumë mirë".

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Atëherë, Emona është dakord. Në lidhje me vlerësimin pas secilit prej votimeve nga të gjithë anëtarët rezultoi me të gjitha kriteret "Shkëlqyeshëm". Por mbaj në konsideratë rezervat e mia në lidhje me propozimet e anëtarëve në këtë mbledhje plenare. Faleminderit!

Klodian Kurushi: Edhe unë jam pjesërisht dakord me projektraportin. Për ato propozime që unë i propozova dhe u miratuan jam dakord. Për pjesën tjetër kam qenë kundër. Faleminderit!

Ilir Rusi: Dakord.

Në lidhje me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...} për vitin 2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Miratimin e "Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për vitin 2022", duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – "Shkëlqyeshëm";
- B. Aftësitë organizative – "Shkëlqyeshëm";
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – "Shkëlqyeshëm";
- D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – "Shkëlqyeshëm".

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – "Shkëlqyeshëm".

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit

nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ilir Rusi: Për shkak të kohëzgjatjes dhe diskutimit të kësaj pike, dhe duke marrë në konsideratë numrin e lartë të çështjeve që kemi për të diskutuar në ditën e sotme, me kërkesë të anëtarëve, një pushim 15 minutash.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.07.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, në shpenzime kapitale, për vitin buxhetor 2024”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:29 dhe mbaroi në orën 16:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Markelian Koça | (anëtar) |
| 7. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 8. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Albens Tabaku* dhe z. *Bledar Bajri*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Buxhetit.*
3. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
6. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice (në sallë).*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, në shpenzime kapitale, për vitin buxhetor 2024”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje vazhdojmë me pikën dy të saj që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, në shpenzime kapitale, për vitin buxhetor 2024”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën relatorit z. Haxhiu.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Të nderuar anëtarë.

Sikurse jeni në dijeni, me miratimin e buxhetit për vitin 2024 me ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 743, datë 29.12.2022 ka detajuar buxhetin vjetor për sistemin gjyqësor për vitin buxhetor 2024.

23

Për vitin 2024, ndër të tjera, në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në shpenzime kapitale (investime) u detajuan fonde në Artikullin 231 “Investime/Aktive afatgjata materiale”, kodi i projektit M290068 “Ndërtime ndërtesash dhe Rikonstruksion i plotë/pjesshëm” në shumën 30,000 mijë lekë, të cilat u administruan në KLGJ 03310, me qëllim financimin e nevojave që do lindin gjatë vitit nga gjykatat, në kuadër të ristrukturimit të tyre.

Kështu, në vijim të kësaj, KLGJ me vendimin nr. 330, datë 03.07.2024, miratoi një pjesë në rishpërndarjen e fondeve në shpenzime kapitale (investime) për nevojat e disa gjykatave, respektivisht, nga kodi “Studime, Projektme, Kërkime” shuma prej 6,850 mijë lekë dhe nga kodi “Ndërtime ndërtesash dhe Rikonstruksion i plotë/pjesshëm” në vlerën 16,192 mijë lekë.

Me shkresën nr. 2901, datë 26.07.2024, nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, janë kërkuar në mënyrë emergjente fonde shtesë në shpenzime kapitale në shumën 10.200 mijë lekë, me argumentimin e nevojës emergjente të dëmtimit të tre ashensorëve (2 nga të cilat përdoren nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë dhe 1 nga Gjykata e Posaçme e Apelit), të cilat janë vënë në përdorim që nga viti 2008. Pra kanë një jetëgjatësi shumë të gjatë, dhe mungesa e tyre në të gjithë godinën cenon funksionalitetin normal të dy gjykatave të posaçme dhe sigurinë e jetës së trupës gjyqësore dhe administratës gjyqësore.

Theksojmë se të dy gjykatat e posaçme, në kërkesat buxhetore të paraqitura në fazën e dytë PBA 25-27, i kanë përfshirë nevojën për fonde për të tre ashensorët, të cilët ishin programuar për vitin buxhetor 2025, kështu që miratimi i shpërndarjes së këtij fondi ul kërkesën për fonde në këto shpenzime për vitin buxhetor 2025.

Pas një analize të situatës së fondeve buxhetore në artikullin 231, kodi i projektit M290068 “Ndërtime të reja dhe Rikonstruksion i plotë/pjesshëm” rezultojnë se janë në shumën 13,808 mijë lekë, të cilat siç theksova edhe më sipër administrohen në KLGJ 03310. Ne kemi vlerësuar rishpërndarjen (transferimin) e fondeve të kërkuara për plotësimin e nevojave të gjykatave të sipërcituara. Fondi i transferuar (i gjithë fondi) do të administrohet nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke qenë se të dy gjykatat, siç ju e dini, ndodhen në një godinë.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin buxhetor, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozoj seancës plenare të KLGJ, shqyrtimin dhe miratimin e relacionit dhe projektvendimit mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore, në programin 03310, në shpenzime kapitale (investime), për Gjykatën e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në shumën 10,200 mijë lekë, për vitin buxhetor 2024, sipas pasqyrës së mëposhtme.

Duk ju falënderuar për vëmendjen, në pritje të ndonjë pyetjeje të mundshme.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Haxhiu!

Ftoj anëtarët prezent në mbledhje, a kanë diskutime?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, në shpenzime kapitale, për vitin buxhetor 2024”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e rishpërndarjes (transferimit) të fondeve buxhetore, në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në shpenzime kapitale (investime), për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, për vitin buxhetor 2024, sipas pasqyrës bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.

2. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.07.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 260, datë 16.05.2024, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:29 dhe mbaroi në orën 16:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 8. <i>Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Albens Tabaku* dhe z. *Bledar Bajri*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
5. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 260, datë 16.05.2024, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje vazhdojmë me pikën tre të saj që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 260, datë 16.05.2024, për kandidaten znj. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar anëtarë, ju kemi paraqitur projektvendimin që u lexua nga ana juaj. Rezulton në lidhje me rrethanat e faktit dhe ligjin e zbatueshëm se Këshilli i Lartë

Gjyqësor me vendimet nr. 233 deri nr.243, datë 02.05.2024 dhe nr.260, datë 16.05.2024 ka shpallur procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/Durrës/Tiranë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, penale dhe administrative.

Afati i kandidimit 16.05.2024. Brenda afatit ka kandiduar znj. {...}, për pozicionin nr.260, 16.05.2024, aktualisht gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë.

Në vijim Këshilli ka miratuar listën e kandidatëve që kanë apo mund të kenë një vlerësim etik-profesional për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura. Në këtë listë është përfshirë edhe zonja {...}.

Është bërë me vendim të Këshilli fillimi i procedurës së verifikimit të kritereve ligjore. Për zonjën {...} jam caktuar unë si relator i çështjes. Është njoftuar për fillimin e procedurës, caktimin e relatorit dhe të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit apo anëtarëve. Nuk rezulton ta ketë ushtruar këtë të drejtë. Në vijim është vijuar me verifikimin e kritereve në lidhje me përvojën profesionale minimale specifike, mospasjes së masës disiplinore. Referuar Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative dhe gjykatës përkatëse.

Ndërkohë, rezulton që gjatë procedurës së verifikimit, në datën 03.07.2024 zonja {...} ka paraqitur një kërkesë me e-mail, bashkëlidhur relacionit, sipas së cilës kërkon që të heqë dorë nga pozicioni nr. 260, shpallur me datën 16.05.2024, si pozicion i lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Në këto kushte, duke e konsideruar të plotë materialin, relatori ia ka përcjellë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës i cili me datën 03.07.2024 ka vendosur në vijim t'ia përcjellë mbledhjes plenare për të konkluduar në lidhje me kërkesën për dorëheqje të zonjës {...}. Dhe propozimi është miratimi i dorëheqjes, i kërkesës së saj. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Koça.

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Kalojmë në votim.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 260, datë 16.05.2024, për kandidaten znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 260, datë 16.05.2024, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.07.2024)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.236 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:29 dhe mbaroi në orën 16:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Markelian Koça | (anëtar) |
| 7. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 8. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Albens Tabaku* dhe z. *Bledar Bajri*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 2. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 4. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
- 5. Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice (në sallë).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.236 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 4 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.236 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar anëtarë!

Projektvendimi u lexua nga ana juaj, kështu që po kaloj direkt tek relacioni bashkëlidhur.

Rezulton se zonja {...} ka kandiduar për pozicionin e shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor nr. 236, datë 02.05.2024. Aktualisht është gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

Në vijim këshilli ka miratuar listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë një vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele ku përfshihet dhe znj. {...}.

Është vendosur nga ana e Këshillit fillimi i procedurës së verifikimit, ndër të tjera edhe për zonjën {...}. Jam caktuar relator i çështjes unë dhe është njoftuar për fillimin e procedurës, për caktimin e relatorit dhe të drejtën për të kërkuar përjashtimin si të relatorit dhe të anëtarëve. Nuk e ka nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe gjykatat përkatëse, në lidhje me verifikimin e “përvojës profesionale minimale specifike” dhe “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

Fusha në të cilën konkurren zonja {...} është në fushën e së drejtës civile dhe për këtë arsye është kërkuar informacion gjykatës përkatëse, pra Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

Nga verifikimet ka rezultuar se në kërkesën për shprehje interesi ka parashtruar se ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Vlorës “Ismail Qemali” në datë 17.07.2007 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020. Me vendim të Këshillit caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet ku prej nga datës 16.11.2022 ka shtruar kompetencat e Zv/Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet. Me vendim nr. 132, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër”, nga data 01.05.2023 transferohet në pozicion të përhershëm si gjyqtare pranë kësaj gjykate. Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, funksion të cilin ushtron edhe aktualisht. Procesverbali është i datës 02.04.2024.

E njëjta situatë rezulton edhe nga krahasimi dhe verifikimi i dokumentacionit përkatës, kështu që nuk po e lexoj nga e para.

Rezulton se vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është tre vite
Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Sa i takon fushën specifike të zonjës, është administruar përgjigjja nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër ku ka rezultuar se ka gjykuar si në Përmet dhe Gjirokastër të gjitha kategoritë e çështjeve, për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve nuk ka pasur ndarje në seksion. Pra nga verifikimi rezulton që rezulton që ka një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtare në fushën e së drejtës civile.

Në lidhje me masën disiplinore është administruar vetëdeklarimi i saj sipas së cilës deklaron që nuk ka masë disiplinore në fuqi. Po ashtu është bërë edhe verifikimi në departamentit përkatës pranë Këshillit nga ku rezulton që nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Sa i takon kriterit të papajtueshmërisë është administruar deklarata e kandidatës sipas së cilës nuk do të ndodhet në kushtet e konfliktit të papajtueshmërisë ambientale në rast se do të emërohet në vendin ku kandidon.

Në këto kushte, duke u konsideruar i plotë dokumentacioni i mbledhur për zonjën {...}, është përcjellë komisionit përkatës i cili me vendimin datë 03.07.2024 ka vendosur t'ia përcjellë mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur kualifikimin ose jo të zonjës {...} për vendin e shpallur me vendimin nr. 236, 02.05.2024 të Këshillit Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Koça!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.236 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 236 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.07.2024)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.242 dhe nr.243, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator ishte z. {...}).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:29 dhe mbaroi në orën 16:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 2. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 3. Irena Plaku*** (anëtare)
- 4. Gentiana Muçaj*** (anëtare)
- 5. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 6. Markelian Koça*** (anëtar)
- 7. Yllka Rupa*** (anëtare)
- 8. Emona Muçi*** (anëtare)

36

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 30.07.2024 (Pika 5)***

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Albens Tabaku* dhe z. *Bledar Bajri*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
5. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.242 dhe nr.243, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator ishte z. {...}).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 5 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.242 dhe nr.243, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për shkak të mbarimit të mandatit të z. {...}, ky akt do të raportohet nga z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar anëtarë!

Projektvendimi u lexua nga Zëvendëskryetari, kështu që po kaloj direkt në relacionin shpjegues.

Me Vendimin nr.233-nr.243, datë 02.05.2024 dhe nr. 260, datë 16.05.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur hapjen e procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/Durrës/Tiranë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, penale dhe administrative.

Afati i kandidimit 16.05.2024. Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë nr.242 dhe nr. 243 datë 02.05.2024 ka kandiduar edhe z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Mbas përfundimit të afatit të kandidimit Këshilli ka miratuar listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshihet dhe z. {...}.

Në vijim, këshilli ka vendosur me vendimin nr. 298, datë 05.06.2024 fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë, dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallura me vendimet nr. 240, 242, dhe 243 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, edhe për zotën {...}, ku është caktuar relator z. {...}. Me caktimin e relatorit është njoftuar për fillimin e procedurës, për verifikimin e kushteve dhe kriterëve, caktimin e relatorit dhe të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit dhe të çdo anëtar tjetër të Këshillit. Nuk është ushtruar kjo e drejtë brenda afatit të caktuar.

Në vijim është administruar dokumentacioni i nevojshëm nga Departamenti i përkatës në Këshillin e Lartë Gjyqësor si dhe gjykata ku kandidati ka ushtruar funksionin, në lidhje me verifikimin e kriterit të “përvojës profesionale specifike minimale” dhe të “mospasjes së masës disiplinore”.

Është marrë informacioni i nevojshëm në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër prej periudhës 13.06.2018 – 31.05.2022 si gjyqtar i transferuar dhe gjyqtar i skemës së delegimit.

Nga verifikimet na ka rezultuar se si në kërkesën e shprehjes së interesit dhe në dokumentacionin e shqyrtuar, ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2015, ndërkohë është emëruar për të kryer stazhin profesional si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për periudhën 31.10.2014 - 23.06.2016, ku ka gjykuar çështje me natyrë të përgjithshme, çështje civile, familjare dhe penale. Në vijim, është emëruar gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, ku ka gjykuar çështje me natyrë të përgjithshme. Më pas me vendim të Këshillit të Lartë Drejtësisë transferohet përkohësisht për një periudhë 1-vjeçare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Me vendimet e KLGJ-së i përsëritet transferimi i përkohshëm pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, për një periudhë deri në datë 07.05.2021. Me vendim e Këshillit të Lartë Gjyqësor deklarohet ndërprerje e transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe caktohet për të shërbyer si pjesë e skemës së delegimit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Nga data 31.05.2022 përfundon shërbimin në skemën e delegimit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe rikthehet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë. Me vendimin nr. 220, datë 28.04.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet për shkak të suprimimit të pozicionit si gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë. Me vendimin nr. 479, datë 13.09.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet sipas procedurës së lëvizjes paralele gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku dhe aktualisht ushtron detyrën. Vjetërsia në punë, edhe nga krahasimi i dokumentacionit, rezulton magjistrat prej 9 vitesh. Z. {...} nuk ka masa disiplinore.

Nga të dhënat rezulton nga dokumentacioni i administruar, ka mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës administrative gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit.

Në lidhje me kriterin e mospasjes së masës disiplinore është administruar vetëdeklarimi se nuk ka masë disiplinore. Nga verifikimi nga departamenti përkatës rezulton se nuk ka masë disiplinore.

Gjithashtu është verifikuar edhe kriteri i papajtueshmërisë ambientale. Është

administruar deklarata 16.05.2024 sipas së cilës kandidati deklaroi se nuk do të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve ligjore.

Gjatë verifikimit nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati. Në këto kushte, i është përcjellë Komisionit materiali përkatës dhe relacioni.

Komisioni në mbledhjen e datës 24.06.2024 duke konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për kriteret ligjore të kandidimit për z. {...} ka vendosur t'ia përcjellë mbledhje plenare për të vendosur kualifikimin ose jo të tij dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallur me pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, me vendimin nr.242 dhe nr. 243 datë 02.05.2024.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Koça!

Në shqyrtimin e kësaj pike, nuk shprehet dhe merr pjesë znj. Plaku.

Ka diskutime për aktin?

Meqenëse nuk ka diskutime, kalojmë në votimin e tij.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.242 dhe nr.243, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

40

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.07.2024)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.242 dhe nr.243, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator ishte z. {...}).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:29 dhe mbaroi në orën 16:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 4. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 5. Markelian Koça | (anëtar) |
| 6. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 7. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Albens Tabaku* dhe z. *Bledar Bajri*.

Gjithashtu nuk merr pjesë në shqyrtimin e kësaj pike *znj. Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
5. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës *znj. {...}* dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.242 dhe nr.243, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator ishte z. {...}).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 6 të këtij rendi dite, në të cilën edhe në këtë pikë nuk merr pjesë *znj. Plaku*. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës *znj. {...}* dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.242 dhe nr.243, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për shkak të mbarimit të mandatit të z. {...}, relatimin do ta bëjë z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Atëherë, pa humbur kohë po lexoj relacionin që i bashkëngjitet projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.242 dhe nr. 243, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Për zonjën {...} mund të themi që ajo ka shprehur interesin në momentin që janë hapur vendet e lira, vakancat e lira në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Tiranë. Në këto dy pozicione të lira të shpallura me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor ka shprehur interesin dhe ka paraqitur kërkesën znj. {...}, e cila aktualisht ushtron funksionin e gjyqtares pranë Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

Referuar nenit 43 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, janë bërë verifikimet nga ana e Komisionit për tre kriteret ligjore formale të cilat duhet të përmbushin kandidatët për të vijuar më tej procedurën e kualifikimit të tyre dhe nga këto verifikime ka rezultuar se zonja {...}, referuar përvojës profesionale brenda 5 viteve të fundit, ka pra një vit përvojë eksperiencë përkatëse si përvojë minimale profesionale në fushën e së drejtës përkatëse që është fusha e së drejtës administrative, pasi siç e thashë ajo prej kohësh ushtron funksionin e gjyqtares në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Lushnje. Nuk ka masë disiplinore në fuqi, nga verifikimet e bëra nga ana jonë si dhe nga deklarata e sjellë nga vetë zonja {...}. Si dhe së fundmi, duke iu referuar kriterit të papajtueshmërisë ambientale, ajo plotëson edhe këtë lloj kriteri pasi në rastin e hipotezës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Tiranë, nuk do të ndodhej në kushtet e papajtueshmërisë ambientale.

Ndodhur në këto kushte, duke përfunduar relatimin, ne propozojmë që zonja {...} plotëson kriteret formale të kandidimit për procedurën e lëvizjes paralele dhe si rrjedhim, referuar nenit 43 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i propozojmë Këshillit kualifikimin e kandidatës dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative për dy pozicione nr. 242 dhe nr. 243 datë 02.05.2024. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

44

Ka diskutime?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.242 dhe nr.243, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 242 dhe nr. 243 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.07.2024)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile dhe penale, të shpallur me vendimin nr.234 dhe nr.237, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:29 dhe mbaroi në orën 16:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 8. <i>Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

46

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 30.07.2024 (Pika 7)***

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Albens Tabaku* dhe z. *Bledar Bajri*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
5. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile dhe penale, të shpallur me vendimin nr.234 dhe nr.237, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 7 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile dhe penale, të shpallur me vendimin nr.234 dhe nr.237, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar anëtarë!

Atëherë, në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, paraqesim projektvendimin e lexuar nga ana juaj, në lidhje me relacionin bashkëlidhur bëj me dije se sipas vendimit nr. 233 - nr.243, datë 02.05.2024 dhe nr.260, datë 16.05.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur hapjen e procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/Durrës/Tiranë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Afati i kandidimit 16.05.2024. Brenda afatit rezultojnë të ketë kandiduar për pozicionin e lirë nr. 234 dhe nr. 237 datë 02.05.2024 edhe z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Në vijim Këshilli ka miratuar listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim etike dhe profesional për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe z. {...}.

Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit, ndër të tjera edhe për z. {...} dhe relator i çështjes jam caktuar unë. Është njoftuar kandidati për fillimin e procedurës, caktimin e relatorit dhe të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit apo anëtarëve. Nuk rezultojnë të ketë ushtruar këtë të drejtë. Ndërkohë është administruar dokumentacioni në vijim nga departamenti përkatës pranë KLGJ-së dhe gjykata ku ka punuar z. {...}, konkretisht Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Nga verifikimet, në lidhje me përvojën minimale profesionale dhe mospasjes së masës disiplinore rezultojnë se z. {...} kandidon në vendimin nr. 234 datë 02.05.2024 në fushën e së drejtës penale dhe nr. 237 datë 02.05.2024, çka do të thotë se duhet të ketë të paktën një vit përvojë profesionale në fushën e së drejtës civile dhe penale gjatë 5 viteve të fundit.

Nga kërkesa për shprehje interesi dhe në vijim nga krahasimi i materialit të administruar, rezultojnë se z. {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në 19.07.2012. Ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master në “E Drejtë Publike”, pranë Universitetit të Tiranës në 2014 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018. Me vendimin nr. 132, datë 19.07.2019 të Këshillit është emëruar gjyqtar. Me vendimin nr. 148, datë 30.07.2019 të Këshillit është caktuar si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Me procesverbalin e Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në datën

07.04.2023 zgjidhet Zëvendëskryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe prej datës 01.05.2023 ushtron funksionin e Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë. Rezulton se vjetërsia në ushtrimin e detyrës është 4 vite dhe nuk ka masë disiplinore.

Në lidhje me fushën e ushtrimit të veprimtarisë është administruar dokumentacioni nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, nga ku rezulton se në periudhën nga data e emërimit 2019 e në vijim Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë nuk ka funksionuar e ndarë në seksione (pra ka gjykuar çështje të natyrës si civile ashtu edhe penale). Ka pasur vetëm një seksion për të mitur. Dhe në këto kushte, nga krahasimi i dokumentacionit rezulton që kandidati të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale në fushën e së drejtës civile dhe penale. por ka qenë e ndarë në trupa gjykues për gjykimin e çështjeve civile/penale.

Për masat disiplinore është administruar deklarimi i z. {...} sipas së cilës nuk ka masë disiplinore në fuqi. Është bërë edhe verifikimi nga Departamenti përkatës. Nuk rezulton ndonjë situatë e ndryshme nga ajo e deklaruar prej tij.

Sa i takon papajtueshmërisë ambientale është administruar deklarata se nuk do të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale.

E njëjta gjë rezulton edhe nga verifikimi i kryer nga ana jonë.

Në këto kushte i është përcjellë relacioni Komisionit, i cili në mbledhjen e datës 24.06.2024 ka vendosur të plotë verifikimin dhe dokumentacionin dhe vendosi kalimin mbledhjes plenare për të konkluduar mbi kualifikimin ose jo të z. {...} për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile/penale të shpallur me vendimin nr.234 dhe nr.237, 02.05.2024, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Koça!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projekt-aktit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Në shqyrtimin e kësaj pike u rikthye zonja Plaku e cila mori pjesë në diskutim për shkak se nuk ka papajtueshmëri për shqyrtimin e këtyre pikave të tjera të këtij rendi dite. Iliri dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile dhe penale, të shpallur me vendimin nr.234 dhe nr.237, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile dhe penale, të shpallur me vendimin nr.234 dhe nr. 237 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.07.2024)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.235 dhe nr.236, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:29 dhe mbaroi në orën 16:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 8. <i>Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Albens Tabaku* dhe z. *Bledar Bajri*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
5. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.235 dhe nr.236, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 8 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.235 dhe nr.236, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Projektvendimi i radhës, po lexoj në mënyrë të përmbledhur relacionin që ka për objekt kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.235 dhe nr.236, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me vendimet nr.233- nr.243, datë 02.05.2024 dhe nr.260, datë 16.05.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur hapjen e procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/Durrës/Tiranë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë nr.235 dhe nr. 236 datë 02.05.2024 ka kandiduar edhe z. {...} gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Rezultatet e verifikimit i referohen tre kritereve ligjore parashikuar nga neni 43 i ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht në bazë të verifikimeve ka rezultuar se nga data 29.01.2020 e në vijim gjyqtari {...} ka filluar dhe vazhdon të ushtrojë funksionin e gjyqtarit fillimisht pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, ku aktualisht ushtron funksionin dhe detyrën e Zëvendëskryetarit të kësaj gjykate.

Z. {...} është verifikuar për përvojën minimale profesionale nga e cila rezulton që ai plotëson të gjitha kriteret, pra brenda 5 viteve të fundit ai është gjyqtar që ka gjykuar çështje të natyrës penale dhe civile në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe si rrjedhojë plotëson kriterin minimal të përvojës profesionale për pozicionet të cilat ai ka shprehur interesin e tij për të kandiduar në procedurat e lëvizjes paralele.

Në lidhje me mospasjen e masës disiplinore, që është kriteri i dytë i parashikuar nga neni 43 i ligjit të përmendur më lart, magjistrati sipas nenit 43 nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se ai ka një masë disiplinore në fuqi. Nga verifikimet e bëra dhe formulari i aplikimit i paraqitur nga vetë kandidati.

Përtej formularit dhe verifikimet e bëra nga Komisioni, rezulton që ai nuk ka asnjë masë disiplinore në fuqi kështu që edhe për këtë kriter kandidati e plotëson këtë kriter pasi nuk ka një masë disiplinore në fuqi.

Ndërsa edhe për kriterin e fundit që i referohet kriterit të papajtueshmërisë ambientale, është një kriter i cili është parashikuar në nenin 8, pika 2 e ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në lidhje me këtë kriter përveç deklaratës së paraqitur nga z. {...} kemi bërë edhe verifikimet tona si Komision, verifikime në kuadrin e procesit administrativ, nga përmbajtja e të cilave rezulton që në rast të mundshëm hipotetik të zhvillimit dhe përfundimit të procedurës së lëvizjes paralele të gjyqtarit z. {...} nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në rast pra të procedurës së lëvizjes paralele të tij në pozicionet e shpallura ku ai ka shfaqur interes, ai nuk do të ndodhet në kushtet dhe në situatat e papajtueshmërisë ambientale.

Ndodhur në këto kushte, pasi kemi bërë tre verifikimet e parashikuara nga neni 43 i ligjit “Për statusin”, i propozojmë Këshillit kualifikimin e kandidatit për pozicionet e lira të shpallura në fushën e së drejtës civile me vendimet nr. 235 dhe 236, datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për

pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.235 dhe nr.236, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.235 dhe nr. 236 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.07.2024)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.237, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:29 dhe mbaroi në orën 16:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Markelian Koça | (anëtar) |
| 7. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 8. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Albens Tabaku* dhe z. *Bledar Bajri*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
5. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.237, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 9 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.237, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar anëtarë!

Ju paraqesim në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës projektvendimin që u lexua nga ana juaj.

Në relacionin përkatës ju bëj me dije se për pozicionin e lirë nr. 237 datë 02.05.2024 të shpallur nga ky Këshill, ka kandiduar z. {...}, brenda afatit të përcaktuar nga ana e Këshillit. Aktualisht ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, i transferuar.

Mbas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim etik dhe profesional për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë. Në këtë listë përfshihet edhe z. {...}.

Në vijim, me vendimin nr. 298, datë 05.06.2024, ka filluar procedura e verifikimit, duke u caktuar unë si relator i çështjes.

Me datën 07.06.2024 është njoftuar kandidati për fillimin e procedurës, caktimin e relatorit dhe të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit apo anëtarëve të Këshillit. Nuk e ka ushtruar këtë të drejtë.

Në vijim është grumbulluar dokumentacioni i nevojshëm nga Departamenti përkatës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe gjykata ku ka ushtruar aktivitetin e tij si gjyqtar, pra ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

Në lidhje me verifikimin e përvojës profesionale minimale specifike, mospasjes së masave disiplinore, krahas administrimit të dokumentacionit nga departamenti i burimeve njerëzore pranë Këshillit, është administruar edhe dokumentacioni nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Sarandë, ku ka ushtruar aktivitetin kandidatit.

Nga kërkesa për shprehje interesi si dhe nga krahasimi i asaj që është deklaruar në dokumentacionin përkatës rezulton se z. {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit European të Tiranës në datë 25.07.2012, ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master në Shkenca Penale pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2014 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019. Me vendimin nr. 11, datë 09.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar. Me vendimin nr. 54, datë 29.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion si gjyqtar pranë

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Me vendimin nr. 99, datë 06.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet përkohësisht për një periudhë 1 (një) vjeçare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë me Juridiksion të Përgjithshëm Durrës. Me vendimin nr. 103, datë 29.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor i përsëritet transferimi në të njëjtën gjykatë. Rezulton se vjetërsia në punë është 4 vite. Zoti {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Është administruar dokumentacioni, siç e thamë nga Gjykata e Sarandës, ku rezulton se për periudhën janar 2020 – mars 2023 ka punuar në të gjitha kategoritë e çështjeve si gjyqtar, pasi gjykata e Sarandës nuk ka pasur ndarje në seksione. Ndërsa me vërtetimin e administruar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës rezulton se është pjesë e dhomës penale në këtë gjykatë. Pra rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës penale.

Sa i takon mospasjes së masës disiplinore është administruar vetëdeklarimi i kandidatit si dhe nga verifikimi gjithashtu nuk ka rezultuar ndonjë situatë e ndryshme.

Po ashtu në lidhje me kriterin e papajtueshmërisë ambientale është administruar deklarimi se nuk do të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale dhe po ashtu, nga verifikimet rezulton se nuk ndodhet në një situatë të tillë në rast se do të realizohet lëvizja paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Në këto kushte relatori ia ka përcjellë Komisionit materialin përkatës dhe në mbledhjen e datës 24.06.2024, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke e konsideruar të plotë verifikimin dhe dokumentacionin e grumbulluar, ka vendosur t'ia përcjellë mbledhjes plenare për të vendosur kualifikimin ose jo të kandidatit për pozicionin nr. 237, datë 02.05.2024 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në fushën e së drejtës penale.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Koça!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.237, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 237 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.07.2024)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.237, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:29 dhe mbaroi në orën 16:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Markelian Koça | (anëtar) |
| 7. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 8. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Albens Tabaku* dhe z. *Bledar Bajri*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
5. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.237, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 10 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.237, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Projektvendimi i radhës i referohet kualifikimit të kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të

62

Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.237, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me vendimin, ndër të tjera, 233 - 243, datë 02.05.2024 (dhe nr.260, datë 16.05.2024), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur hapjen e procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/Durrës/Tiranë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, penale dhe administrative.

Brenda afateve të kandidimit që ishte afati i fundit datë 16.05.2024 dhe 30.05.2024, ka paraqitur kërkesë duke shprehur interesin edhe zonja {...} e cila në kohën e paraqitjes së kërkesës ushtron funksionin në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, aktualisht ajo është transferuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Pas shortit dhe përzgjedhjes së relatorit nëpërmjet shortit që jam unë, vijuan procedurat e verifikimit të tre kritereve ligjore, procedura të cilat janë parashikuar nga neni 43 i ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në procedurat e verifikimit të tre kritereve ligjore ka rezultuar se fillimisht zonja {...} siç thamë është gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë. Transferuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Me vendim nr. 131, datë 28.03.2023 ka ushtruar funksionin e zëvendëskryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë. Me vendimin nr. 170, datë 03.04.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet përkohësisht si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një periudhë 1 (një) vjeçare. Vlen të theksojmë se brenda afatit 5-vjeçar znj. {...} plotëson kriterin ligjor të përvojës profesionale minimale pasi më tepër se sa një vit ajo ka ushtruar funksionin e gjyqtares duke gjykuar përveç çështjeve civile edhe çështje penale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë. Kështu që në këtë aspekt ajo plotëson kriteret e parashikuara nga neni 43 i ligjit “Për statusin”, kriterin e pasjes së përvojës minimale profesionale në fushën përkatëse ku është hapur edhe vakanca e lirë e përhershme me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Njëkohësisht, për kriterin e dytë të mospasjes së masës disiplinore në fuqi, përveç deklaratës së paraqitur nga vetë kandidatja e cila deklaron që nuk ka masa disiplinore në fuqi, pra nuk ka pengesë për të kandiduar në këtë pozicion, Komisioni ka bërë verifikimet përkatëse dhe nga verifikimet e bëra nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, ka rezultuar se zonja {...} nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Në lidhje me kriterin e papajtueshmërisë ambientale, kriter i cili parashikohet në nenin 8 të ligjit “Për statusin”, sipas deklaratës së paraqitur nga kandidatja por edhe verifikimeve të bëra nga Komisioni përkatës rezulton se kandidatja nuk do të ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë ambientale, nëse ajo do të transferohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele në pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendim të cilin unë e relatova si pjesë të këtij relacioni.

Ndodhur në këto kushte ne si Komision propozojmë kualifikimin e kandidates dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 237, datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi ajo plotëson të gjitha kriteret ligjore të parashikuara nga neni 43 i ligjit “Për statusin”. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.237, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 237 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.07.2024)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.238, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator ishte z. {...}).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:29 dhe mbaroi në orën 16:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Markelian Koça | (anëtar) |
| 7. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 8. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Albens Tabaku* dhe z. *Bledar Bajri*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
5. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.238, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator ishte z. {...}).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 11 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.238, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për shkak të mbarimit të mandatit të z. {...}, ky akt do të raportohet nga z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar anëtarë!

Nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ju paraqesim projektvendimin e lexuar nga ana juaj. Në relacionin përkatës bëj me dije se:

Sipas pozicioneve të lira të shpallura nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor për pozicionin e lirë nr. 238 datë 02.05.2024 ka kandiduar znj. {...} gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, aktualisht e komanduar në pozicionin “Ndihmësmagjistrate” në Njësinë e Shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit të shprehjes së interesit, Këshilli ka miratuar listën e kandidatëve që kanë apo mund të kenë një vlerësim etik dhe profesional për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë përfshihet dhe znj. {...}.

Me vendimin nr. 298, datë 05.06.2024 ka filluar procedura e verifikimit duke u caktuar si relator i çështjes z. {...}. Është njoftuar në datën 07.06.2024 kandidatja për fillimin e procedurës, caktimin e relatorit dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e anëtarëve të Këshillit dhe të relatorit. Nuk është ushtruar kjo e drejtë.

Në vijim është mbledhur dokumentacioni përkatës nga Departamenti pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor si dhe gjykata ku ka punuar kandidatja, në lidhje me verifikimin e kriterit të përvojës profesionale minimale specifike dhe të mospasjes së masave disiplinore.

Nga dokumentacioni i grumbulluar si më lart, duke iu referuar kërkesës për shprehje interesi dhe dokumentacionit të depozituar dhe administruar nga Departamenti përkatës pranë Këshillit, rezulton se zonja {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” në datën 03.07.2006, ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master në “E drejtë publike” pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2015 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020. Me vendimin nr. 481, datë 20.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtare. Me vendimin nr. 507, datë 27.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Me vendimin nr. 131, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”, nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Me vendimin nr. 323, datë 14.06.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor komandohet në pozicionin “Ndihmësmagjistrate” në

Njësinë e Shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Lartë, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, ku dhe aktualisht ushtron funksionin. Vjetërsia në ushtrimin e detyrës është 3 vite. Znj. {...} nuk ka masa disiplinore.

Është administruar dokumentacioni përkatës nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier sipas së cilës {...} ka gjykuar çështje të seksionit civil. Kopje të vendimit nr. 360, 22.07.2021 të Këshillit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier administruar dhe në bazë të këtij vendimi znj. {...} ka gjykuar çështje të seksionit penal dhe civil. Dhe me vendimin nr. {...} prot. datë 13.09.2022 të Këshillit të Gjykatës rezulton se ka gjykuar çështje të seksionit penal.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale është marrë informacion nga Gjykata e Lartë dhe nga verifikimet e kryera rezulton se magjistratja {...}, e komanduara në Njësinë e Shërbimit Ligjor, nga data 15.06.2023 e në vazhdim, respektivisht është atashuar (duke marrë parasysh nevojat e kolegjeve të Gjykatës së Lartë) pranë Kolegjit Penal nga Kryetari i Gjykatës së Lartë.”.

Pra nga verifikimet rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtare në fushën e së drejtës civile.

Nuk ka masa disiplinore. Rezulton se është administruar vetëdeklarimi se nuk ka masë disiplinore dhe po ashtu nga Departamenti i Burimeve Njerëzore në Këshill na rezulton se nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Në lidhje me kriterin e papajtueshmërisë është administruar deklarimi se nuk do të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale dhe po ashtu nga verifikimet nuk rezulton ndonjë e dhënë e ndryshme.

Në këto kushte i është përcjellë Komisionit materiali përkatës nga ana e relatorit dhe Komisioni në mbledhjen e datës 24.06.2024 ka vendosur se është i plotë dokumentacioni i grumbulluar për të dhe verifikimet e kryera dhe në këto kushte t'i kalojë mbledhjes plenare të vendosi kalimin ose jo, pra kualifikimin ose jo të kandidatës dhe vijimin e procedurës në lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, shpallur me vendimin 238, 02.05.2024. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Koça!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.238, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 238 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsytuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.07.2024)

Pika 12 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.238 dhe nr. 239 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:29 dhe mbaroi në orën 16:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 8. <i>Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Albens Tabaku* dhe z. *Bledar Bajri*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
5. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

12. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.238 dhe nr. 239 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 12 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 238 dhe nr. 239 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Po lexoj relacionin e radhës që i bashkëlidhet projektvendimit “Për kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimet nr. 238 dhe nr. 239 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Me vendimet nr.233 - nr.243, datë 02.05.2024 dhe nr.260, datë 16.05.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi hapjen e procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/Durrës/Tiranë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, penale dhe administrative.

Në këto procedura të lëvizjes paralele, afati i kandidimit ishte data 16.05.2024 dhe data 30.05.2024.

Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me nr. 238 dhe nr. 239, datë 02.05.2024 kandidoi edhe znj. {...}, e cila aktualisht është gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

Menjëherë, pasi filluar procedurat e verifikimit të kriterëve ligjore dhe u hodh shorti për anëtarët të cilët do të verifikonin kriteret formale, për zonjën {...} u shortova unë si anëtar i Komisionit të Karrierës, për të vijuar procedurën e verifikimit të kriterëve ligjore të parashikuara nga neni 43 i ligjit “Për statusin”.

Në vijim të veprimtarisë së Komisionit mbi verifikimin e tre kriterëve ligjore të parashikuara nga neni 43 i ligjit “Për statusin”, për zonjën {...} ka rezultuar si më poshtë nga ky verifikim:

Në lidhje me kriterin e përvojës profesionale specifike minimale, rezulton se zonja {...}, ndër të tjera (shkurtimisht pra po e citoj), ajo ka mbaruar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020. Me vendim të KLGJ-së emërohet gjyqtar dhe më pas caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Me vendimin nr. 131, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”, nga data 01.05.2023 transferohet në pozicion të përhershëm si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, ku dhe aktualisht ajo e ushtron këtë funksion në këtë gjykatë.

Lidhur me përvojën minimale specifike profesionale na rezulton që në 5 vitet e fundit zonja {...} plotëson kushtin e përvojës minimale profesionale specifike në fushën e së drejtës përkatëse, pasi brenda afatit 1-vjeçar që e kërkon ligji ajo ka gjykuar çështje të natyrës civile (më tepër se sa një vit) respektivisht në gjykatat ku ajo ka ushtruar funksionet e saj specifike si në Gjykatën e Shkallës së Parë Lushnjë, ashtu edhe pas krijimit të hartës, miratimit të hartës dhe prodhimit të pasojave që solli kjo hartë, si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

Kështu që në këtë aspekt, zonja {...} plotëson kushtet e përvojës minimale specifike në fushën e së drejtës përkatëse të hapur si vend vakant me anë të vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në lidhje me kriterin e dytë që i referohet masave disiplinore, rezulton se zonja {...} ka plotësuar formularin e vetëdeklarimit nga e cila rezulton që ajo nuk ka masë disiplinore në fuqi. Njëkohësisht përveç formularit, ne kemi bërë edhe verifikimet përkatëse në Këshill, në drejtorinë përkatëse, për verifikimin ndaj zonjës {...} gjatë kohës që ajo ushtron funksionin e gjyqtares në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, ka apo jo masë disiplinore në fuqi, dhe ka rezultuar që ndaj saj nuk ekziston që të ketë masë disiplinore në fuqi. Ndodhur në këto kushte, plotësohet edhe kriteri i dytë i mospasjes masë disiplinore, parashikuar nga neni 43 i ligjit “Për statusin”. Njëkohësisht zonja {...} plotëson edhe kriterin e tretë të parashikuar nga neni 43 i ligjit “Për statusin” që është kriteri i mospasjes së papajtueshmërisë ambientale, parashikuar si kriter nga neni 8, paragrafi i dytë i ligjit “Për statusin”.

Pas verifikimeve të bëra nga ana jonë si dhe deklaratës së paraqitur nga zonja {...}, Komisioni konkludon që në rastin hipotetik të transferimit të zonjës {...} nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, nga gjykata ku ajo ushtron funksionet, në gjykatën ku ajo ka shprehur dëshirën e saj Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ajo në këtë procedurë transferimi nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, nuk do të ndodhej në situatën e papajtueshmërisë ambientale.

Ndodhur në këto kushte ne mendojmë se zonja {...} plotëson të gjitha kriteret ligjore formale të parashikuara nga neni 43 i ligjit “Për statusin”, për t’u kualifikuar dhe si kandidate e tillë ne i propozojmë Këshillit që të pranojë propozimin tonë për kualifikimin e kandidates dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e

Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimet nr.238 dhe nr. 239 datë 02.05.2024. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.238 dhe nr. 239 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 238 dhe nr. 239 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 12 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.07.2024)

Pika 13 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.238 dhe nr. 239 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:29 dhe mbaroi në orën 16:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 8. <i>Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Albens Tabaku* dhe z. *Bledar Bajri*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
5. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

13. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.238 dhe nr. 239 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 13 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.238 dhe nr. 239 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Po lexoj relacionin për projektvendimin “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimet nr.238 dhe nr. 239 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Me Vendimet nr.233- nr.243 dhe nr.260, të datave respektive 02.05.2024 dhe 16.05.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur hapjen e procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/Durrës/Tiranë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, penale dhe administrative.

Brenda afatit të kandidimit për pozicionet e lira nr. 238 dhe nr. 239, datë 02.05.2024 kandidoi edhe znj. {...} gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë e transferuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Fillimisht për shkak të shprehjes së interesit të zonjës {...} për të kandiduar në pozicionet e lira të shpallura me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor të përmendura më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksioneve të përgjithshme Durrës, Tiranë, Fier, të shpallura me vendimet respektive të përmendura më lart. Si dhe për këtë kandidatë jam shortuar unë si relator për të vijuar dhe ndjekur procedurën e verifikimit të kritereve ligjore të parashikuara nga neni 43 i ligjit “Për statusin”.

Në procesin e verifikimit të kritereve ligjore referuar nenit 43, fillimisht jemi ndalur në verifikimin e kriterit të përvojës profesionale specifike minimale për zonjën {...}. Nga ky verifikim ka rezultuar se zonja {...} ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018. Me vendimin e Këshillit ajo emërohet gjyqtare dhe caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Me procesverbalin e Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, në datë 03.11.2020 zgjidhet Zëvendëskryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe në datën 01.05.2023 ushtron funksionin e Zv/Kryetares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë. Me vendimin nr. 527, datë 11.10.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet përkohësisht si gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë

të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ku aktualisht ushtron funksionin pranë kësaj gjykate. Referuar përvojës minimale specifike, nga verifikimet tona ka rezultuar se në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, ku paraprakisht ajo ka ushtruar funksionet e gjyqtares (pra kandidatja ka ushtruar funksionet e gjyqtares pranë kësaj gjykate), rezulton ky verifikim: “Për shkak të numrit të gjyqtarëve që ishte i kufizuar në Gjykatën e Shkallës së Parë Sarandë, gjyqtarët e asaj gjykate kanë gjykuar të gjitha llojet e çështjeve të ndara vetëm në dy trupa gjykues. Gjyqtarja znj. {...} në atë periudhë kohe ka gjykuar si çështje të natyrës civile ashtu edhe çështje të natyrës penale. Njëkohësisht, në këtë rast është bërë edhe verifikimi i kopjeve të vendimit të Këshillit të Gjykatës për formimin e trupave gjykues, statistikave për çështjet e gjykuar për gjyqtaren znj. {...} për vitet 2020, 2021 dhe 2022.”.

Njëkohësisht sipas informacioneve që ne kemi marrë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ku ajo aktualisht ushtron funksionet, nga verifikimet e kryera rezulton se për kandidaten, me vendimet nr. {...} prot., datë 16.01.2024 dhe nr. 21, datë 15.04.2024, rezulton se znj. {...} është pjesë e dhomës civile në këtë gjykatë.

Ndodhur në këto kushte ne si komision konkludojmë që zonja {...}, referuar nenit 43 të ligjit “Për statusin”, plotëson kriteret minimale specifike në pozicionin për të cilin ajo kandidon, që është në fushën e së drejtës civile.

Njëkohësisht referuar kriterit të dytë të mospasjes masë disiplinore në fuqi, nga verifikimet e bëra nga ana jonë ka rezultuar se zonja {...} ka përmbushur detyrimin për të plotësuar formularin e vetëdeklarimit, nga përmbajtja e së cilës rezulton që ajo nuk ka një masë disiplinore në fuqi.

Njëkohësisht nga verifikimet e bëra nga ana jonë nëpërmjet informacioneve të sjella prej Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, rezulton se zonja {...} si kandidate nuk ka asnjë masë disiplinore në fuqi.

Ndodhur në këto kushte konkludojmë që edhe kriteri i dytë është i përmbushur nga zonja {...}.

Kriteri i tretë i referohet rastit të papajtueshmërisë ambientale si kriter i parashikuar nga neni 8, pika 2 e ligjit “Për statusin”. Edhe në lidhje me këtë kriter janë bërë verifikimet përkatëse, përveç deklaratës së marrë nga zonja {...}, ne kemi bërë

verifikimet tona dhe nga të gjitha verifikimet rezulton se ajo nuk do të ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë ambientale, nëse do të transferohet nëpërmjet procedurës së lëvizjeve paralele. Aktualisht ajo ushtron funksionet e gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

Ndodhur në këto kushte, ne mendojmë që plotësohen të gjitha kriteret ligjore, kështu që propozojmë kualifikimin e zonjës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimet nr.238 dhe nr. 239 datë 02.05.2024. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.238 dhe nr. 239 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 238 dhe nr. 239 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 13 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.07.2024)

Pika 14 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 238 dhe nr. 239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator ishte z. {...}).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:29 dhe mbaroi në orën 16:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Markelian Koça | (anëtar) |
| 7. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 8. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Albens Tabaku* dhe z. *Bledar Bajri*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
5. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

14. Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 238 dhe nr. 239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator ishte z. {...}).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 14 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 238 dhe nr. 239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Meqenëse zotit {...} i ka mbaruar mandati, ftoj relatorin z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar anëtarë!

Ju paraqesim në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës projektvendimin që u lexua nga ana juaj në lidhje me vendimet nr. 238 dhe nr. 239, datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në relacionin përkatës ju bëj me dije se Këshilli me vendimet nr. 233 - nr. 243, datë 02.05.2024 dhe nr. 260, datë 16.05.2024, ka vendosur hapjen e procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/Durrës/Tiranë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, penale dhe administrative. Afati i kandidimit është 16.05.2024. Brenda afatit ka kandiduar zonja {...}, për pozicionet e lira nr. 238 dhe 239, 02.05.2024. Aktualisht znj. {...} është gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Në vijim Këshilli ka miratuar listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim etik dhe profesional për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë përfshihet znj. {...}.

Ndërkohë, me vendimin nr. 298, datë 05.06.2024, Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për të gjithë kandidatët për pozicionet e lira, ndër të tjera edhe për pozicionet në të cilën kandidon zonja {...} dhe për këtë kandidate është caktuar relator z. {...}.

Është njoftuar kandidatja për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për caktimin e relatorit të kësaj procedure dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit dhe anëtarëve. Nuk e ka ushtruar këtë të drejtë brenda afatit të caktuar.

Në vijim Këshilli (pra relatori) ka vijuar me grumbullimin e dokumentacionit përkatës nga Departamenti i Burimeve Njerëzore pranë Këshillit dhe në gjykatat ku ka ushtruar funksionin si gjyqtare zonja {...}.

Në lidhje me verifikimin e kriterëve të përvojës profesionale minimale specifike dhe mospasjes së masave disiplinore në fuqi, nga dokumentacioni i grumbulluar si dhe kërkesën për shprehje interesi, rezulton se zonja {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 19.07.2012, dhe ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master në “E drejtë civile” pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2014, ndërsa Shkollën e Magjistraturës e ka përfunduar në vitin 2019.

Me vendimin nr. 7, datë 09.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtare. Me vendimin nr. 46, datë 29.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Me vendimin nr. 363, datë 14.09.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet përkohësisht për një periudhë 1-vjeçare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Me vendimin nr. 400, datë 23.09.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor i përsëritet transferimi i përkohshëm pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, për një periudhë 1-vjeçare në datën 01.05.2023 dhe në vijim ushtron funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Me vendimin nr. 480, datë 13.09.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet sipas procedurës së lëvizjes paralele pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ku dhe aktualisht ushtron detyrën. Vjetërsia në punë në total është 4 vite. Nuk rezulton të ketë masa disiplinore.

Në lidhje me verifikimin e kriterit specifik për vjetërsinë e punës në funksion në fushën përkatëse, është administruar dokumentacioni nga gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër sipas së cilës rezulton se zonja {...}, sipas vendimit të gjykatës Shkodër 04.02.2020 është gjyqtare e dhomës civile, seksioni civil. Sipas vendimit të gjykatës Shkodër 24.03.2021 është gjyqtare e dhomës civile, seksioni civil. Ndërkohë, nga informacioni i përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, pas implementimit të hartës gjyqësore, rezulton se zonja {...} ka gjykuar çështje penale, civile, familjare dhe urdhra ekzekutimi pranë ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë duke qenë se gjyqtarët nuk kanë qenë të ndarë në dhoma specifike nga data 21.09.2021 deri 30.04.2023.

Po ashtu nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës është administruar dokumentacioni dhe përgjigjja se zonja {...} është pjesë e dhomës civile, sipas vendimit nr. {...} prot., 27.09.2023 dhe nr. {...}, datë 16.01.2024, të Këshillit të kësaj gjykate.

Pra rezulton se kandidatja ka mbi 1 vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtare në fushën e së drejtës civile.

Në lidhje me kriterin e mospasjes së masës disiplinore, është administruar formulari i nënshkruar prej saj se nuk ka masë disiplinore. Nga verifikimet nga

departamenti përkatës i Këshillit nuk rezulton ndonjë situatë e ndryshme. Pra rezulton që nuk ka masë disiplinore.

Në lidhje me kriterin e papajtueshmërisë është administruar deklarata se nuk do të ndodhet në situatë papajtueshmërie ambientale sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit 8 të ligjit 96/2016 “Për statusin”.

Nga verifikimet po ashtu nuk ka rezultuar se mund të ketë ndonjë të dhënë në lidhje me situatën e papajtueshmërisë të ndryshme nga ajo të deklaruar nga zonja {...} në rast se do të realizohet lëvizja paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në këto kushte, duke konsideruar të plotë dokumentacionin dhe verifikimet e kryera, relatori ka përcjellë materialin Komisionit, i cili me datën 24.06.2024 edhe ky e ka konsideruar të plotë dokumentacionin dhe verifikimet e kryera dhe ka vendosur t’ia përcjellë mbledhjes plenare materialin në lidhje me vlerësimin për kualifikimin ose jo të kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 238 dhe nr. 239, datë 02.05.2024.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Koça!

Ka diskutime?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë,

87

për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 238 dhe nr. 239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 238 dhe nr. 239 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 14 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.07.2024)

Pika 15 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimet nr. 238 dhe nr.239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:29 dhe mbaroi në orën 16:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 8. <i>Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Albens Tabaku* dhe z. *Bledar Bajri*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
5. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

15. Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimet nr. 238 dhe nr.239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 15 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimet nr. 238 dhe nr.239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorin z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar anëtarë!

Ju paraqesim në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës projektvendimin “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimet nr. 238 dhe nr.239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Në relacionin përkatës në lidhje me gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm ju bëj me dije se, me vendimet nr. 233 - nr. 243, datë 02.05.2024 dhe nr. 260, datë 16.05.2024, KLGJ-ja ka vendosur hapjen e procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/Durrës/Tiranë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, penale dhe administrative. Afati i kandidimit 16.05.2024. Brenda afatit rezultoi se ka kandiduar për pozicionet e lira nr. 238 dhe 239, 02.05.2024 edhe z. {...}, aktualisht gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

Në vijim Këshilli ka miratuar listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim etik dhe profesional për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë përfshihet edhe z. {...}.

Po ashtu Këshilli, me vendimin nr. 298, datë 05.06.2024, ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele, ndër të tjera edhe për pozicionet ku kandidon zoti {...}, ndërsa jam caktuar unë si relator për këtë kandidat.

Është njoftuar në datën 07.06.2024 kandidati për fillimin e procedurës, caktimin e relatorit si dhe të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit dhe anëtarëve të Këshillit. Nuk është ushtruar kjo e drejtë brenda afatit ligjor.

Në vijim është bërë e mundur administrimi i dokumentacionit përkatës nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit si dhe gjykatat ku kandidati ka ushtruar funksionin si gjyqtar.

Në lidhje me verifikimin e kriterëve të përvojës profesionale minimale specifike dhe mospasjes së masave disiplinore, dokumentacioni është marrë nga Departamenti pranë Këshillit si dhe nga gjykata përkatëse, konkretisht Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

Sa i takon përvojës minimale në kërkesën për shprehje interesi si dhe nga verifikimi i dokumentacionit përkatës rezulton se zoti {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës më 13.07.2010 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020. Me vendimin nr. 467, datë 20.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar. Me vendimin nr. 515, datë 27.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, në datë 13.03.2023 zgjidhet Zëvendëskryetar kësaj gjykate. Me vendimin nr. 135, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës”, prej datës 01.05.2023 transferohet në pozicion të përhershëm si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, ku dhe aktualisht ushtron funksionin. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit si magjistrat, 3 vite. Për zotin {...} nuk rezulton të ketë masa disiplinore.

Në lidhje me fushën specifike në ushtrimin e aktivitetit si gjyqtar është administruar kërkesa pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës dhe përgjigjja se pranë kësaj gjykate nuk ka ndarje në seksione për gjykimin e çështjeve penale apo civile. Gjyqtari {...} është emëruar gjyqtar në ish Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë në tetor 2020 dhe ushtron këtë detyrë pa shkëputje në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se ka mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile.

Në lidhje me masat disiplinore është administruar deklarimi personal i kandidatit se nuk ka masë disiplinore dhe po ashtu nga verifikimi pranë departamentit përkatës rezulton se nuk ka masa disiplinore.

Në lidhje me kriterin e papajtueshmërisë ambientale rezulton se është administruar deklarimi i kandidatit se nuk do të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale dhe po ashtu edhe nga verifikimet e kryera nuk rezulton ndonjë e dhënë e ndryshme e deklaruar nga kandidati nëse do të realizohet lëvizja paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në këto kushte, duke u konsideruar të plotë materialin, pra dokumentacionin e grumbulluar dhe verifikimet e kryera, i është përcjellë Komisionit ky material dhe me datën 24.06.2024 Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka konkluduar se dokumentacioni është i plotë, verifikimet janë të plota dhe duhet t'i përcillet mbledhjes plenare për të vendosur për kualifikimin ose jo të z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 238 dhe nr. 239, datë 02.05.2024.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Koça!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimet nr. 238 dhe nr.239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 238 dhe nr. 239 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 15 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.07.2024)

Pika 16 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 238, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator ishte z. {...}).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:29 dhe mbaroi në orën 16:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 8. <i>Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Albens Tabaku* dhe z. *Bledar Bajri*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
5. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

16. Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 238, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator ishte z. {...}).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 16 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 238, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për shkak të përfundimit të mandatit të z. {...}, ky akt do të relatohet nga z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar anëtarë!

Kemi paraqitur për shqyrtim projektvendimin “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 238, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Në relacionin bashkëlidhur ju bëj me dije se z. {...} kandidon për pozicionin e lirë nr. 238 datë 02.05.2024, shpallur nga Këshilli. Aktualisht është gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

Në vijim Këshilli ka miratuar listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim etik dhe profesional për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë edhe z. {...}.

Me vendimin nr. 298, datë 05.06.2024, Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele edhe për pozicionin ku kandidon z. {...}. Është caktuar si relator i çështjes zoti {...}.

Është njoftuar në datën 07.06.2024 kandidati për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për caktimin e relatorit si dhe të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit apo të anëtarëve të Këshillit. Nuk është ushtruar kjo e drejtë brenda afatit të caktuar nga Këshilli.

Në vijim nga ana e relatorit ka filluar puna për mbledhjen e dokumentacionit të nevojshëm dhe kryerjen e verifikimit në lidhje me verifikimin e përvojës profesionale minimale specifike dhe atë të mospasjes së masës disiplinore në fuqi, duke kërkuar dokumentacionin përkatës pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës dhe Departamenti përkatës pranë këtij këshilli.

Nga verifikimet ka rezultuar, nisur nga kërkesa për shprehje interesi dhe dokumentacioni i mbledhur se z. {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit “Luarasi” në datën 03.07.2013, ka përfunduar studimet Master i Shkencave, në profilin “E drejtë penale” në Universitetin “Luarasi” në datë 16.07.2015 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019. Me vendimin nr. 15, datë 09.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar. Me vendimin nr. 55, datë 29.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Me vendimin nr. 538, datë 14.12.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor komandohet në pozicionin “Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të

Antikorrupsionit” në Ministrinë e Drejtësisë, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare. Me vendimin nr. 107, datë 29.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor deklarohet përfundimi para afatit të kohëzgjatjes së komandimit në pozicionin e mësipërm në Ministrinë e Drejtësisë dhe rikthehet në pozicionin pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës. Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të kësaj gjykate, në datë 13.03.2024 zgjidhet Zëvendëskryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, funksion të cilin ushtron edhe aktualisht. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 4 vite. Z. {...} nuk rezulton të ketë masa disiplinore.

Nga informacioni i marrë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës është kthyer përgjigje se: “Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës nuk kemi ndarje në seksione për gjykimin e çështjeve penale apo civile. Gjyqtari {...} ka gjykuar çështje penale dhe civile përgjatë gjithë kohës që ka ushtruar detyrën si gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës dhe në gjykatat e rretheve gjyqësorë që i janë bashkuar kësaj gjykate. Gjyqtari {...} është emëruar gjyqtar në ish-Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës në janar 2020 dhe ka ushtruar këtë detyrë deri në dhjetor 2022, ku me vendim të KLGJ-së është transferuar në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, është rikthyer në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Kukës në mars 2024.”.

Ndërkohë, lidhur me përvojën profesionale të kandidatit si Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit” në Ministrinë e Drejtësisë, në kushtet kur Ligji 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, konkretisht në nenin 53, pika 9 e tij, parashikon vetëm llogaritjen e kësaj përvoje si përvojë profesionale në shkallë të parë, pa e lidhur me një fushë specifike të së drejtës, vlerësohet se, për sa kohë nuk ka një specifikim të tillë nga ligji, përvoja e kandidatit do të konsiderohet si përvojë profesionale specifike në fushën e të drejtës civile, penale dhe administrative.

Nga verifikimi rezulton pra se ka mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile.

Në lidhje me masat disiplinore është administruar deklarimi i kandidatit se nuk ka masë disiplinore dhe po ashtu nga verifikimi nga departamenti përkatës i Këshillit rezulton se nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Në lidhje me kriterin e papajtueshmërisë është administruar deklarimi i kandidatit se nuk do të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë sipas përcaktimeve të pikës 3, neni 8 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”; dhe po ashtu nga verifikimet nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë e ndryshme mbi papajtueshmërinë ambientale për sa kohë kandidon në lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Duke e konsideruar të plotë dokumentacionin e grumbulluar dhe verifikimet e kryera, relatori ia ka përcjellë Komisionit materialin përkatës i cili në datën 24.06.2024 ka vendosur t’ia përcjellë mbledhjes plenare duke e konsideruar po ashtu edhe Komisioni të plotë verifikimin dhe dokumentacionin e mbledhur. E në këto kushte i takon Këshillit për të vendosur për kualifikimin ose jo të kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 238, 02.05.2024.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Koça!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për

99

pozicionin e lire në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 238, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 238 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Atëherë, në vijim të kësaj mbledhjeje, të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe për shkak të vendimmarrjes së ditës së sotme por edhe për shkak të rëndësisë dhe efektivitetit të akteve të cilat ne shqyrtojmë, nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, përgjatë mbledhjes së ditës së sotme dhe ju janë vënë në dispozicion materialet, janë përcjellë materiale në lidhje me fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile shpallur me vendimin nr. 243, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për të cilin do të ketë short.

Keni diskutime për përfshirjen e saj në rendin e kësaj mbledhjeje?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk keni diskutime, vazhdojmë në votimin e saj për ta përfshirë në rend dite të ditës së sotme apo jo.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Atëherë në këtë rend dite do përfshihet edhe projekt-akti “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile shpallur me vendimin nr. 243, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Për këtë njoftoj administratën të njoftojë punonjësën përkatës që në një moment të caktuar të përgatisë infrastrukturën për hedhjen e shortit.

Ilir Rusi: Për shkak edhe të kohës së gjatë të kësaj mbledhjeje dhe intensitetit të akteve, me kërkesën e anëtarëve, propozojmë 10 minuta pushim.

* * *

(Pika 16 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.07.2024)

Pika 17 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lire në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 238, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator ishte z. {...}).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:29 dhe mbaroi në orën 16:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Irena Plaku*** (anëtare)
4. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
5. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
6. ***Markelian Koça*** (anëtar)
7. ***Yllka Rupa*** (anëtare)*
8. ***Emona Muçi*** (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Albens Tabaku* dhe z. *Bledar Bajri*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
5. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

17. Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lire në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 238, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator ishte z. {...}).

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje, zonja Rupa për arsye objektive do të jetë “online”. Dhe kuorumi i nevojshëm është. Vazhdojmë mbledhjen.

Vazhdojmë me pikën 17 të saj, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lire në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 238, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për shkak të përfundimit të mandatit të z. {...}, akti do të raportohet nga z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar anëtarë!

Ju paraqesim në emër të Komisionit projektvendimin “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 238, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Në relacionin bashkëlidhur ju bëj me dije se Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimet nr. 233 – 243, 02.05.2024 dhe nr.260, 16.05.2024 ka vendosur hapjen e procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/Durrës/Tiranë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, penale dhe administrative.

Afati i aplikimit 16.05.2024. Brenda afatit ka aplikuar për pozicionin nr. 238, 02.05.2024 z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Në vijim Këshilli ka miratuar listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim etik dhe profesional për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë edhe z. {...}.

Me vendimin nr. 298, datë 05.06.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele, ndër të tjera për pozicionin ku kandidon zoti {...}. Për zotën {...} është caktuar relator zoti {...}.

Në datën 07.06.2024 është njoftuar kandidati për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për caktimin e relatorit të kësaj procedure, për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e dhe anëtarëve të Këshillit. Brenda afatit nuk është ushtruar kjo e drejtë.

Në vijim relatori ka nisur punën për grumbullimin e dokumentacionit dhe kryerjen e verifikimeve të nevojshme në lidhje me kriteret e përvojës profesionale minimale specifike dhe të mospasjes së masës disiplinore, duke kërkuar dokumentacion nga departamenti përkatës pranë Këshillit dhe gjykatës ku ka ushtruar funksionin z. {...}, konkretisht Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe Elbasan.

Nga verifikimet i dokumentacionit, kryqëzuar edhe me kërkesën për shprehje interesi nga zoti {...}, rezulton se kandidati ka përfunduar studimet në Drejtësi, titulli

Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 20.07.2011, ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master në “E drejtë civile” në Universitetit të Tiranës në vitin 2013 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018. Me vendimin nr. 130, datë 19.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është emëruar gjyqtar. Me vendimin nr. 153, datë 30.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Me vendimin nr. 129, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër”, prej datës 01.05.2023 ka ushtruar funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Me vendimin nr. 529, datë 11.10.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet përkohësisht pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një periudhë 1 (një) vjeçare. Me vendimin nr. 216, datë 25.04.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet sipas procedurës së lëvizjes paralele pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ku aktualisht ushtron funksionin. Vjetërsia e punës në funksionin e magjistratit është 4 vite. Z. {...} nuk rezulton të ketë masa disiplinore.

Në lidhje me fushën e ushtrimit të aktivitetit ose funksionit si gjyqtar rezulton se “Për periudhën korrik 2019 deri më tetor 2023, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, ka punuar si gjyqtar, në tetor të vitit 2023, është transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Ka gjykuar në të gjitha kategoritë e çështjeve, konkretisht çështje penale, civile, familjare dhe tregtare, pasi Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve nuk ka pasur të ndarë seksionet apo dhoma të veçanta, pra penale dhe civile.”

Nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, nga verifikimet e kryera, rezulton se është kthyer përgjigje: Bëhet me dije se z. {...} gjykon në seksionin civil sipas vendimit nr.4/1, 01.11.2023 të Këshillit të Gjykatës.

Në konkluzion arrijmë në përfundimin se ka mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile.

Në lidhje me mospasjen e masës disiplinore si kriter është administruar vetëdeklarimi se nuk ka masë disiplinore, datë 14.05.2024 dhe po ashtu nga Departamenti

i Burimeve Njerëzore nuk rezulton informacion i kundërt, pra një situatë e ndryshme, rezulton gjithashtu se nuk ka masë disiplinore.

Në lidhje me kriterin e papajtueshmërisë ambientale është administruar deklarimi i kandidatit se nuk do të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3 neni 8 të ligjit 96/2016 “Për statusin”.

Po ashtu nga verifikimet nuk rezulton ndonjë e dhënë e ndryshme e deklaruar nga kandidati nëse vijon procedura për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në këto kushte, relatori i ka përcjellë Komisionit materialet duke e konsideruar të plotë verifikimin dhe dokumentacionin e mbledhur. Më datë 24.06.2024, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për kriteret ligjore të kandidimit të z. {...}, vendosi t’i përcjellë mbledhjes plenare kalimin për shqyrtim të situatës, pra vlerësimit, nëse i plotëson apo jo kushtet si kandidat dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 238, datë 02.05.2024.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Koça!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për

106

pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimet nr. 238, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 238 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 17 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.07.2024)

Pika 18 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 238 dhe nr. 239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:29 dhe mbaroi në orën 16:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Irena Plaku*** (anëtare)
4. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
5. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
6. ***Markelian Koça*** (anëtar)
7. ***Yllka Rupa*** (anëtare)*
8. ***Emona Muçi*** (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Albens Tabaku* dhe z. *Bledar Bajri*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
5. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

18. Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 238 dhe nr. 239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Kalojmë në pikën 18 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 238 dhe nr. 239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilën është përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës relacioni përkatës. Më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit z. Rusi!

Atëherë, po lexoj relacionin që i bashkëlidhet projektvendimit “Për kualifikimin e z. {...}...”

(Z. Kurushi gabimisht lexon titullin e projektvendimit që u miratua përpara.)

Ju kërkoj ndjesë! Po korrigjoj fillimin e relacionit. Po lexoj relacionin që i bashkëlidhet projektvendimit “Për kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 238 dhe nr. 239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Me Vendimin nr.233 - nr.243, datë 02.05.2024 dhe nr.260, datë 16.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur hapja e procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/Durrës/Tiranë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, penale dhe administrative.

Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë nr. 238 dhe nr. 239, datë 02.05.2024 kandidoi edhe znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Për vijimin e procedurave mbi verifikimin e kritereve formale Këshilli ka marrë një vendim datë 16.05.2024, me nr. 260, nëpërmjet të cilit autorizoi fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Durrës, Tiranë, dhe Fier të shpallura me vendimet nr. 234, 235, 236, 237, 238, 239, datë 02.05.2024 dhe nr. 260, datë 16.05.2024. Për këto procedura u caktuan edhe relatorët përkatës dhe në lidhje me kandidaten znj. {...} jam shortuar unë si relator i ndjekjes së procedurave të verifikimit të kritereve formale.

Verifikimi i tre kritereve ligjore formale është parashikuar në nenin 43 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Kriteret ligjore për të cilat ka nisur verifikimin Komisioni lidhen me: përvojën profesionale specifike minimale, mospasjen e masës disiplinore në fuqi si dhe në situatën e mospasjes së papajtueshmërisë ambientale.

Në lidhje me të tre kriteret ligjore janë bërë verifikimet përkatëse dhe ka rezultuar se kandidatja plotëson të gjitha kriteret ligjore të parashikuara nga neni 43 i ligjit. Pra ajo plotëson kriterin e përvojës minimale specifike, nuk ka masë disiplinore në fuqi si dhe nuk do të ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë ambientale.

110

Ndodhur në këtë situatë ne konsiderojmë që verifikimet janë bërë të plota dhe i propozojmë Këshillit kualifikimin e kandidates dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimet nr.238 dhe nr.239 datë 02.05.2024.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 238 dhe nr. 239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 238 dhe nr. 239 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 18 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.07.2024)

Pika 19 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 238 dhe 239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:29 dhe mbaroi në orën 16:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Markelian Koça | (anëtar) |
| 7. Yllka Rupa | (anëtare)* |
| 8. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Albens Tabaku* dhe z. *Bledar Bajri*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
5. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

19. Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 238 dhe 239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 19 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lire në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 238 dhe 239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit z. Rusi!

Po lexoj relacionin që i bashkëlidhet projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës

së Parë të Juridiksionit Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 238 dhe 239, datë 02.05.2024”

Me Vendimet nr.233 - nr.243, datë 02.05.2024 dhe nr. 260, datë 16.05.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi hapjen e procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/Durrës/Tiranë si dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, penale dhe administrative.

Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë nr. 238 dhe nr. 239, datë 02.05.2024 kandidoi edhe z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, gjyqtar i cili aktualisht është i komanduar në pozicionin e këshilltarit juridik në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Me fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të parashikuara nga neni 43 i ligjit “Për statusin”, për pozicionet të cilat i përmenda më lart, unë jam shortuar si relator për të ndjekur dhe verifikuar kriteret formale ligjore që parashikon neni 43 për kandidatin z. {...}.

Si rezultat i verifikimit të kriterëve ligjore të parashikuara nga neni 43 që bën fjalë për përvojën profesionale specifike, për mospasjen e masës disiplinore në fuqi si dhe për kriterin e papajtueshmërisë ambientale, nga verifikimet e bëra ka rezultuar që kandidati i plotëson të gjitha kriteret ligjore të parashikuara nga neni 43 i ligjit, kështu që nuk ka asnjë lloj pengese për të vijuar më tej garën e tij në pozicionet ku ai ka shprehur interes për t’u përfshirë në procedurat e lëvizjes paralele.

Ndodhur në këto kushte unë propozoj kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimet nr.238 dhe nr.239 datë 02.05.2024.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 238 dhe 239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 238 dhe nr. 239 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 19 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.07.2024)

Pika 20 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:29 dhe mbaroi në orën 16:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)*</i> |
| 8. <i>Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Albens Tabaku* dhe z. *Bledar Bajri*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
5. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

20. Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Kalojmë në pikën 20 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit z. Rusi!

Po lexoj projektvendimin dhe relacionin që i bashkëlidhet atij, që ka për objekt kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në

Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Me Vendimet nr.233 - nr.243, si dhe nr. 260, të datave 02.05.2024 dhe 16.05.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi hapjen e procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/Durrës/Tiranë si dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, penale dhe administrative.

Në këto procedura të lëvizjes paralele ka shprehur interes dhe ka paraqitur kërkesë edhe kandidati z. {...} i cili aktualisht është gjyqtar dhe zëvendëskryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

Menjëherë, pas marrjes së kandidaturave, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të të gjithë kandidatëve në procedurat e lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm Durrës, Tiranë, Fier, të shpallura me vendimet përkatëse si dhe kandidatët që kandiduan për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Për zotin {...}, nëpërmjet procedurës së shortit jam caktuar unë si relator, që kam vijuar procedurën e verifikimit të kriterëve ligjore të parashikuara nga neni 43 i ligjit “Për statusin”.

Kriteret ligjore të parashikuara nga neni 43 i ligjit “Për statusin” janë kriteret që lidhen me pasjen e përvojës profesionale specifike minimale që është ndër 5 vitet e fundit 1 vit ai të ketë ushtruar funksionin e gjyqtarit në fushën e së drejtës përkatëse ku ka shprehur interesin dhe është hapur vakanca e përherëshme. Kriteri i dytë lidhet me mospasjen e masës disiplinore si dhe kriteri i tretë lidhet me situatën e papajtueshmërisë ambientale.

Nga verifikimet e që ne kemi bërë ka rezultuar që z. {...} plotëson të gjitha kriteret ligjore të parashikuara nga neni 43 i ligjit “Për statusin”, për të vijuar më tej garën në procedurën e lëvizjes paralele. Pra nuk ka asnjë shkak të arsyeshëm ligjor që do ta pengonte zotin {...} për vijimin e procedurave të transferimit të tij nëpërmjet procedurës së lëvizjeve paralele.

Ndodhur në këto kushte unë propozoj kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.239 datë 02.05.2024.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 239 datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsytuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

120

* * *

(Pika 20 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.07.2024)

Pika 21 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:29 dhe mbaroi në orën 16:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Markelian Koça | (anëtar) |
| 7. Yllka Rupa | (anëtare)* |
| 8. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Albens Tabaku* dhe z. *Bledar Bajri*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
5. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

21. Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 21 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Koça.

Klodian Kurushi: Faleminderit z. Rusi!

Të nderuar anëtarë!

Në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës ju paraqesim për shqyrtim projektvendimin “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në relacionin bashkëlidhur bëj me dije se në kuadër të vendeve të shpallura nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor me vendimet e 02.05.2024, 16.05.2024, me afat aplikimi deri në datën 16.05.2024 ka kandiduar për pozicionin e lirë nr. 239, 02.05.2024 zonja {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, aktualisht e komanduar në pozicionin “Ndihmësmagjistrate” në Njësinë e Shërbimit ligjor në Gjykatën e Lartë.

Në vijim këshilli ka miratuar listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim etik dhe profesional për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe znj. {...}.

Me Vendimin nr. 298, datë 05.06.2024, Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele dhe konkretisht edhe për zonjën {...} ku relator i çështjes jam caktuar unë me datën 07.06.2024, në respektim të detyrimit të përcaktuara nga vendimi i KLGJ-së. Është njoftuar kandidatja për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; caktimin e relatorit; të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit dhe anëtarëve të Këshillit, e drejtë e cila nuk është ushtruar brenda afatit të përcaktuar nga ligji.

Në vijim relatori ka vijuar punën për grumbullimin dokumentacionit të nevojshëm dhe kryerjen e verifikimeve në lidhje me kriteret e përvojës profesionale minimale specifike, mospasjes së masave disiplinore, duke kërkuar informacion nga departamenti përkatës pranë KLGJ-së dhe gjykatës ku ka ushtruar detyrën/funksionin si gjyqtare zonja {...}.

Nga verifikimet e kryera rezulton se në kërkesën me të cilën shpreh interes për vendin vakant si dhe në dokumentacionin e grumbulluar, zonja {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 28.05.2011 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020. Me vendimin nr. 472, datë

20.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar. Me vendimin nr. 504, datë 27.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Me vendimin nr. 133, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë”, prej datës 01.05.2023 transferohet në pozicion të përhershëm në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë. Me vendimin nr. 321, datë 14.06.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor komandohet në pozicionin “Ndihmësmagjistrate” në Njësinë e Shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Lartë, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare. Vjetërsia totale në punë e funksionit si magjistrat është 3 vite. Nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, ku janë kryer verifikimet përkatëse rezulton se, në lidhje me përvojën specifike si gjyqtar në fushën e drejtësisë civile znj. {...}, sipas tabelave të përpunuara nga zyra e Shërbimit Kurbin në lidhje me të dhënat statistikore ka punuar për vitet 2021, 2022 dhe 2023 dhe nuk rezulton të ketë pasur në këtë gjykatë seksione civile dhe penale pra kanë punuar si një gjykatë e vetme duke mbuluar fushat e të drejtës civile e penale njëkohësisht. Bashkëlidhur janë edhe tabelat përkatëse.

Nga verifikimet në Gjykatën e Lartë, në përgjigje të komunikimit telefonik është informuar Këshilli se magjistrate znj. {...} e komanduar në Njësinë e Shërbimit Ligjor, nga data 15.06.2023 e në vazhdim, respektivisht është atashuar (duke marrë parasysh nevojat e kolegjeve të Gjykatës së Lartë) pranë Kolegjit Civil. Pra nga verifikimet rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën në e të drejtës civile.

Në lidhje me kriterin e mospasjes së masave disiplinore është administruar deklarimi i kandidatës se nuk ka masë disiplinore në fuqi 16.05.2024.

Po ashtu nga informacioni i përcjellë nga Departamenti përkatës pranë Këshillit, rezulton se nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me kriterin e papajtueshmërisë ambientale është administruar deklarimi i datës 16.05.2024 sipas së cilit kandidatja deklaroi se nuk do të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3 të nenit 8 të ligjit 96/2016 “Për statusin”, dhe po ashtu nga verifikimi nuk rezulton ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa kohë kandidon

në lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në përfundim, duke e konsideruar të plotë verifikimin dhe dokumentacionin e mbledhur, relatori ia ka përcjellë komisionit materialin përkatës dhe komisioni në mbledhjen e datës 24.06.2024 po ashtu ka konsideruar të plotë procedurën e verifikimit të kritereve ligjore dhe dokumentacionin e mbledhur dhe ka vendosur t'ia përcjellë mbledhjes plenare vlerësimin për kualifikimin ose jo të kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.239 datë 02.05.2024.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Koça!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.239 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për

pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 239 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 21 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.07.2024)

Pika 22 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:29 dhe mbaroi në orën 16:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Markelian Koça | (anëtar) |
| 7. Yllka Rupa | (anëtare)* |
| 8. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Albens Tabaku* dhe z. *Bledar Bajri*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
5. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

22. Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 22 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 239 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar anëtarë!

Projektvendimi (titulli) u lexua nga ju, po kaloj direkt tek relacioni.

Në vendet e shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimet e datës 02.05.2024, 16.05.2024 rezulton që brenda afatit të kandidimit 16.05.2024 ka kandiduar zonja {...} për pozicionin e lirë nr. 239, 02.05.2024. Aktualisht znj. {...} është gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier si emërim, dhe ushtron detyrën si “Këshilltare” në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Këshilli në vijim ka miratuar listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim etik dhe profesional për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe znj. {...}.

Me Vendimin nr. 298, datë 05.06.2024, Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele ndër të tjera edhe për zonjën {...} ku relator i çështjes jam caktuar unë.

Me datën 07.06.2024, është njoftuar kandidatja për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; caktimin e relatorit të kësaj procedure të verifikimit; për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit dhe çdo anëtar i Këshillit. Nuk është ushtruar kjo e drejtë brenda afatit të caktuar nga ana e Këshillit dhe në vijim relatori ka vijuar me grumbullimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe kryerjen e verifikimit në lidhje me kriteret e përvojës minimale specifike dhe të mospasjes së masave disiplinore për zonjën {...}, duke marrë informacion nga Departamenti përkatës në Këshill dhe gjykata ku ka ushtruar funksionin si gjyqtare konkretisht Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës në lidhje edhe me kërkesën për shprehje interesi, rezulton se znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datën 30.06.2011 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020. Me vendimin nr. 474, datë 20.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar. Me vendimin nr. 509, datë 27.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Me vendimin nr. 50, datë 27.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor komandohet në pozicionin “Këshilltar” në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për një afat deri në 5 (pesë) vjet, ku dhe aktualisht ushtron funksionin. Me vendimin nr. 131, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”, prej datës 01.05.2023 transferohet në pozicion të përhershëm në strukturën e Gjykatës së

Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit si magjistrat, 3 vite. Nuk rezulton të ketë masa disiplinore.

Në lidhje me fushën e ushtrimit të veprimtarisë të funksionit si gjyqtare rezulton se është marrë informacion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje sipas urdhrimit të mësipërm të kryetarit të gjykatës 05.01.2017 rezulton se znj. {...} për periudhën 28.10.2020 - 31.01.2023 ka gjykuar çështje te seksionit penal dhe civil. Gjithashtu, bëhet me dije se për sa i përket ndarjes në seksione të ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje rezulton urdhri i fundit i Kryetarit të Gjykatës mbi ndarjen në dhoma, me nr. {...} prot., datë 05.01.2017 (i cili është vënë në dispozicion). Pas këtij urdhri deri në datën 30.04.2023 nuk rezulton që nga ana e kryetarit të ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje të jetë nxjerrë ndonjë urdhër tjetër.

Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës cituar më lart, rezulton të ketë mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile.

Në lidhje me masat disiplinore është administruar vetëdeklarimi se nuk ka masë disiplinore dhe po ashtu, nga Departamenti i Burimeve Njerëzore pranë Këshillit rezulton se nuk ka masë disiplinore.

Në lidhje me kriterin e papajtueshmërisë ambientale është administruar deklarimi se nuk ndodhet dhe nuk do të ndodhet në një situatë papajtueshmërie ambientale sipas pikës 3 të nenit 8 të ligjit 96/2016 “Për statusin”. Gjatë verifikimit po ashtu nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja në lidhje me papajtueshmërinë ambientale për sa kandidon në lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në këto kushte relatori ka përcjellë dokumentacionin Komisionit, duke vlerësuar se janë kryer verifikimet dhe dokumentacioni është i plotë. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në mbledhjen e datës 24.06.2024 po ashtu ka konkluduar se janë kryer të plota verifikimet e procedurës për kriteret ligjore të kandidimit dhe për zonjën {...} është mbledhur i gjithë dokumentacioni i nevojshëm dhe duhet t’i kalojë mbledhjes plenare për të vlerësuar dhe vendosur për kualifikimin ose jo të kandidatës zonjës {...} dhe për vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 239, datë 2.05.2024. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Koça!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.239 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 239 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 22 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.07.2024)

Pika 23 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:29 dhe mbaroi në orën 16:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. **Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
2. **Klodian Kurushi** (anëtar)
3. **Irena Plaku** (anëtare)
4. **Gentiana Muçaj** (anëtare)
5. **Ridvan Hado** (anëtar)
6. **Markelian Koça** (anëtar)
7. **Yllka Rupa** (anëtare)*
8. **Emona Muçi** (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Albens Tabaku* dhe z. *Bledar Bajri*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
5. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

23. Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 239, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 23 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 239 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit z. Rusi!

Të nderuar anëtarë!

Ju paraqesim në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës projektvendimin që u citua nga ana juaj në lidhje me pozicionin nr. 239, 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në relacionin përkatës ju bëj me dije se sipas vendimeve të shpallura nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vendet në lëvizje paralele me vendimet 02.05.2024, 16.05.2024, ndër të tjera, brenda afatit të kandidimit 16.05.2024 kandidon edhe z. {...} sipas kërkesës për pozicionin e lirë nr. 239, 02.05.2024. Z. {...} aktualisht është gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

Në vijim këshilli ka miratuar listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë një vlerësim etik dhe profesional për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë përfshihet edhe z. {...}.

Me Vendimin nr. 298, 05.06.2024, Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit, ndër të tjera edhe për zotin {...}, duke u caktuar unë si relator i çështjes.

Me datën 07.06.2024, z. {...} është njoftuar për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; caktimin e relatorit të kësaj procedure si dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit dhe apo çdo anëtar tjetër të Këshillit. Brenda afatit të caktuar nga ana e Këshillit nuk është ushtruar kjo e drejtë nga ana e kandidatit. Në këto kushte relatori ka vijuar me verifikimin e dokumentacionit, me grumbullimin e dokumentacionit të nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore pranë Këshillit si dhe gjykatës ku ka ushtruar funksionin z. {...}, pra funksionin si magjistrat, si gjyqtar për verifikimin e kriterëve të përvojës profesionale minimale specifike dhe mospasjes së masave disiplinore.

Nga verifikimet e dokumentacionit si dhe kërkesës për shprehje interesi rezulton se zoti {...} ka kryer studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 09.07.2009 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020. Me vendimin nr. 465, datë 20.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar. Me vendimin nr. 510, datë 27.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Me vendimin nr. 140, 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë”, prej datës 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së

Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë. Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, në datën 16.10.2023 zgjidhet Zëvendëskryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, funksion të cilin ushtron edhe aktualisht. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 3 vite. Nuk rezulton të ketë masë disiplinore në fuqi.

Në lidhje me përvojën specifike nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë bëhet me dije se për shkak të numrit të kufizuar të gjyqtarëve, gjyqtarët gjykojnë të gjitha llojet e çështjeve të ndarë në dy trupa gjykues. Gjyqtari z. {...} në këtë periudhë ka gjykuar si çështje civile ashtu edhe çështje penale. Bashkëlidhur informacioni i Këshillit të Gjykatës për formimin e trupave gjykues, statistikave të çështjeve të gjykuara të gjyqtarit {...} për vitet 2021, 2022 dhe 2023.

Nga sa më lart rezulton të ketë kandidati {...} mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e të drejtës civile.

Në lidhje me kriterin e mospasjes së masës disiplinore kandidati ka depozituar formularin e vetëdeklarimit për masat disiplinore 16.05.2024 në përbërje të të cilit bën me dije përkundrejt përgjegjësisë ligjore se nuk ka masë disiplinore në fuqi. Edhe nga verifikimet e kryera nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit rezulton se zoti {...} nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Në lidhje me kriterin e papajtueshmërisë ambientale, ashtu sikundër kandidatët e tjerë, kandidati ka depozituar formularin e vetëdeklarimit për situatën e papajtueshmërisë ambientale 16.05.2024 nëpërmjet të cilit kundrejt përgjegjësisë ligjore deklaroi se nuk do të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3 të nenit 8 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Edhe nga verifikimet e kryera nga ana jonë, nuk rezulton ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati për sa kandidon për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në këto kushte, relatori në përfundim të grumbullimit të informacionit dhe dokumentacionit të nevojshëm ia ka përcjellë Komisionit materialin përkatës dhe në mbledhjen e datës 24.06.2024 Komisioni i Zhvillimit të Karrierës e ka konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për kriteret ligjore për z. {...} dhe ka vendosur t’ia

përcjellë mbledhjes plenare vlerësimin për kualifikimin ose jo të kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.239, datë 02.05.2024.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Koça!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.239 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 239 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

137

* * *

(Pika 23 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.07.2024)

Pika 24 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Elbasan, për pozicionin e lire në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimet nr. 233, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator ishte z. {...}).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:29 dhe mbaroi në orën 16:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Markelian Koça | (anëtar) |
| 7. Yllka Rupa | (anëtare)* |
| 8. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Albens Tabaku* dhe z. *Bledar Bajri*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
5. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

24. Shqyrtim i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Elbasan, për pozicionin e lire në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimet nr. 233, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator ishte z. {...}).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 24 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimet nr. 233, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për shkak të përfundimit të mandatit të z. {...}, ky akt do të relatohet nga z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit z. Rusi!

Të nderuar anëtarë!

Në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës ju paraqesim projektvendimin, titulli i të cilit u lexua nga Zëvendëskryetari.

Në relacionin përkatës bëj me dije se në vendimet e shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, 02.05.2024 dhe 16.05.2024, për hapjen e procedurave të lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Durrës, Tiranë, në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Tiranë për pozicionet që janë në fushën e të drejtës civile, penale, administrative rezulton se brenda afatit të kandidimit, 16.05.2024, për pozicionin nr. 233, 02.05.2024 ka kandiduar edhe zonja {...} aktualisht gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

Në vijim këshilli ka miratuar listën e kandidatëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim etike dhe profesionale (shtojca nr. III) për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe znj. {...}.

Me vendimin nr. 298, 05.06.2024, Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan të shpallur me vendimin nr. 233, datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim. Është caktuar për zonjën {...} si relator z. {...}.

Me datën 07.06.2024, është njoftuar kandidatja për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit apo çdo anëtar tjetër të Këshillit, të drejtë të cilën nuk e ka ushtruar brenda afatit të përcaktuar nga vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në vijim relatori ka nisur punën për grumbullimin e informacionit dhe administrimin e dokumentacionit të nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore pranë Këshillit si dhe dosjen personale të regjistrit të gjyqtarëve nga gjykata ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, me qëllim verifikimin e kriterëve profesionale minimale specifike dhe të mospasjes së masave disiplinore, duke u marrë pra nga Departamenti dhe Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë informacioni i kërkuar.

Nga mbledhja e dokumentacionit, shqyrtimi i tij në lidhje me sa është kërkuar edhe në kërkesën për shprehje interesi nga ana e kandidates, rezulton se ka përfunduar studimet në degën drejtësi titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datën 19.07.2012. Ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master në “E drejtë Penale” në Universitetin e Tiranë në vitin 2014 si dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2022. Me vendimin nr. 312, datë 20.07.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar. Me vendimin nr. 334, datë 22.07.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Me vendimin nr. 141, 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë”, prej datës 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 1 vit. Znj. {...} nuk rezulton të ketë masa disiplinore.

Sa i takon përvojës specifike profesionale, nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë është përcjellë informacioni: Me vendimin nr. {...} prot, datë 14.09.2022 ka qenë gjyqtare e gjykimit të çështjeve të përgjithshme (gjykimin e çështjeve penale dhe civile). Me vendimin e Këshillit të Gjykatës nr. {...} prot, 14.11.2023, dhe në vijim, është gjyqtare e seksionit të përgjithshëm e cila gjykon të gjitha çështjet përveç atyre që gjykon seksioni i të miturve.

Pra nga dokumentacioni arrijmë në përfundimin se kandidatja rezulton të ketë mbi 1 vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtare në fushën e së drejtës civile.

Në lidhje me kriterin e mospasjes së masave disiplinore është administruar formulari i vetëdeklarimit për masat disiplinore 16.06.2024 nëpërmjet të cilit, deklarohet prej saj se nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Po ashtu nga verifikimi nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit rezulton se zonja {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me kriterin e papajtueshmërisë ambientale, është administruar deklarimi prej saj 16.06.2024, nëpërmjet të cilit kundrejt përgjegjësisë ligjore kandidati deklaroi se nuk do të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3 të nenit 8 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Gjatë verifikimit nuk rezulton gjithashtu ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa kandidon në lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Në këto kushte relatori duke konsideruar të plotë materialin e grumbulluar dhe dokumentacionin, ka vendosur t’ia përcjellë Komisionit për shqyrtim. Komisioni në mbledhjen e datës 24.06.2024 e ka konsideruar të plotë procedurën e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për znj. {...} për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, dhe ka vendosur t’ia përcjellë mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për kualifikimin ose jo të zonjës {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 233, datë 02.05.2024.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Koça!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.233 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

143

1. Kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 233, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 24 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.07.2024)

Pika 25 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, i ndryshuar”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:29 dhe mbaroi në orën 16:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Irena Plaku*** (anëtare)
4. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
5. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
6. ***Markelian Koça*** (anëtar)
7. ***Yllka Rupa*** (anëtare)*
8. ***Emona Muçi*** (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Albens Tabaku* dhe z. *Bledar Bajri*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 2. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 4. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
- 5. Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice (në sallë).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

25. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, i ndryshuar”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 25 të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, i ndryshuar”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Akt i cili do të raportohet nga drejtoresha znj. Ngucaj.

Blerta Ngucaj: Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 91, pika 3 e Ligjit 115/2016, me vendimin nr. 280, datë 10.12.2019, të ndryshuar nëpërmjet disa vendimmarrjesh, ka vendosur caktimin e gjyqtarëve, në pozicionin e Gjyqtarit për Mediat në gjykatat, duke përfshirë ato të apeleve, të apelit (ndjesë), të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe në gjykatat e posaçme.

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është administruar me aktin nr. {...} prot., datë 01.07.2024 kërkesa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, në të cilën kërkohet zëvendësimi i gjyqtarit të medias pranë kësaj gjykate, znj. {...}, për shkak të paaftësisë së përkohshme në punë.

Zëvendëskryetari i gjykatës ka bërë me dije se gjyqtarja e medias znj. {...}, rezulton që prej datës 20.06.2024 me raport paralindjeje. Sa më sipër, znj. {...}, e caktuar si Gjyqtare për Median nuk mund të ushtrojë përkohësisht këtë funksion pranë kësaj gjykate.

Në këto kushte, Zëvendëskryetari ka bërë me dije se, në mbledhjen e trupës gjyqësore të zhvilluar për propozimin e një gjyqtari për mediat, ka shprehur pëlqimin për ushtrimin e kësaj detyre, gjyqtarja znj. {...}, e cila ka marrë dakordësinë e trupës gjyqësore.

Në lidhje me zëvendësimin e saj si gjyqtare e medias, znj. {...} ka paraqitur kundërshtimet e saj, të administruara në KLGJ nëpërmjet shkresës me nr. {...} prot., datë 01.07.2024. Në datën 15.07.2024, nëpërmjet shkresës me numër {...} prot. gjyqtares i është kthyer përgjigje në të cilën argumentohet se Këshilli i Lartë Gjyqësor si autoriteti përgjegjës për mbarëvajtjen e marrëdhënieve të gjyqësorit me publikun çmon të nevojshme caktimin e një gjyqtari të medias pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, deri në kohën e rikthimit efektivisht në detyrë të znj. {...}, kjo në përputhje me angazhimet e gjyqtarit të medias në bazë të udhëzuesit për marrëdhënien me median si dhe gjithë kuadrit rregullator.

Me qëllim garantimin e përmbushjes së detyrimit kushtetues për informimin e publikut në lidhje me veprimtaritë e gjykatës, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, në zbatim të nenit 91 të ligjit nr. 115/2016, vendimit nr. 590 datë 26.11.2020 “Për miratimin e Planit Strategjik të Komunikimit për sistemin gjyqësor”, ka përgatitur projektvendimin “Për ndryshimin e Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, “Për caktimin e Gjyqtarit të Medias”.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet ndryshimi i pikës 1 të vendimit nr. 280, duke zëvendësuar përkohësisht gjyqtaren për mediat në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, znj. {...} me gjyqtaren znj. {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se ngarkohet Gjyqtari për Mediat i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, të marrë masat për zbatimin e këtij vendimi.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi menjëherë e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe botimin në faqen zyrtare të internetit.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ngucaj!

Keni diskutime për sa u parashtrua?

Pra keni diskutime për sa u relatua?

(Nuk ka diskutime.)

Vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, i ndryshuar”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Në pikën 1 të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019 “Për caktimin e Gjyqtarëve për Mediat”, i ndryshuar me vendimet nr. 292, datë 06.07.2021; nr. 424, datë 29.09.2021; nr. 254, datë 07.07.2022; nr. 515, datë 21.11.2022, nr. 101, datë 06.03.2023; nr. 662, datë 02.11.2023, nr. 248, datë 02.05.2024 dhe nr. 272, datë 29.05.2024 gjyqtari për mediat në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, znj. {...} zëvendësohet përkohësisht në këtë detyrë nga gjyqtarja znj. {...}.

2. Ngarkohet Gjyqtari për Mediat i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë të marrë masat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 25 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.07.2024)

Pika 26 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

26.1 Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

26.2 Për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

26.3 Për përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim për gjyqtarin z. {...}.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:29 dhe mbaroi në orën 16:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

- 1. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 2. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 3. Irena Plaku*** (anëtare)
- 4. Gentiana Muçaj*** (anëtare)
- 5. Ridvan Hado*** (anëtar)

150

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 30.07.2024 (Pika 26)***

6. *Markelian Koça* (anëtar)
7. *Yllka Rupa* (anëtare)*
8. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Albens Tabaku* dhe z. *Bledar Bajri*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
5. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

26. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

26.1 Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

26.2 Për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

26.3 Për përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim për gjyqtarin z. {...}.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 26 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës të cilat kanë të bëjnë me: Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor; Për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës; Për përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim për gjyqtarin z. {...}; për të cilat është përgatitur relacioni përkatës nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit z. Rusi!

Ne kemi parashtruar tre projektvendime dhe një relacion për shkak se të tre projektvendimet, për shkak të marrëdhënieve juridike që ato krijojnë, ndryshojnë, shuajnë si dhe për shkak të subjektit të kandidatit që është i njëjtë ndër to, kemi parashtruar të tre këto projektvendime në të njëjtin relacion, të cilin unë po e parashtroj përpara Këshillit në mënyrë të përmbledhur.

Me disa vendime të datës 18.01.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) hapi katërbëdhjetë procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 23, hapi procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 23 datë 18.01.2023, kandiduan gjithsej 3(tre) kandidatë, sipas tabelës që vijon: z. {...}, në atë kohë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë; znj. {...} gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan; dhe z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për tre procedurat në proces, mbështetur në pikën 9, të vendimit nr. 23/2023, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr.77, datë 13.02.2023, Këshilli miratoi

152

listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë; që kanë ose mund të kenë një vlerësim; ata që s'kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

Për këtë pozicion nuk ka pasur kandidatë më 2 (dy) vlerësime, por ka pasur tre kandidatë që mund të kenë nga 1 vlerësim sipas vendimit respektiv.

Në kushtet kur në pozicionin nr. 23 nuk kishte kandidatë të kualifikuar me dy vlerësime, Këshilli me vendimin nr. 295, datë 30.05.2023 vendosi: "Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallura me vendimet nr. 22 dhe nr. 23, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose që mund të kenë 1 (një) vlerësim.

Po në këtë vendim u caktuan relatorët për çdo kandidat.

Më pas për kandidatët verifikuam kriteret formale të përvojës profesionale minimale, mospasjes masë disiplinore dhe mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale (për kandidatët që ne i përmendëm më lart).

Për znj. {...}, Këshilli me vendimin nr. 351, datë 06.07.2023 vendosi kualifikimin e kandidates dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për z. {...}, Këshilli me vendimin nr. 332, datë 21.06.2023 vendosi kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në vijim znj. {...} u tërhoq nga kandidimi i saj për këtë pozicion të lirë, dhe Këshilli me vendimin nr. 134, datë 13.03.2024 vendosi përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

Për z. {...}, Këshilli me vendimin nr. 352, datë 06.07.2023 vendosi, ndër të tjera, përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

Duke qenë se kandidatët për këtë pozicion janë kualifikuar, Këshilli caktoi nëpërmjet shortit relatorin e përzgjedhjes për këtë pozicion. Konkretisht, me vendimin nr. 205, datë 17.04.2024, Këshilli vendosi fillimin e procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë/Durrës edhe për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e tij nr. 23 datë 18.01.2023. Me këtë vendim, si relator i procedurës së përzgjedhjes u caktova unë për të vijuar më tej procedurat e përzgjedhjes të cilat po i relatoj ditën e sotme.

Kandidati, pasi u njoftua për caktimin e relatorit nuk kishte kërkesa për përjashtimin e tij.

Dhe për të vijuar më tej, në zbatim të pikës 106, të vendimit të Këshillit nr. 320/2020, relatori administroi dokumentacionin në fazën e përgatitjes së relacionit të përzgjedhjes së kandidatëve për pozicionin e lirë të shpallur, për të cilin ata kandidonin, nr. 23/2023.

Relatori administroi në këtë rast të gjithë dokumentacionin që gjendet në dosjen personale si dhe praktikën dokumentare të procedurave të verifikimit të plotësimit të kriterëve të kandidimit. Relatori administroi edhe vendimin nr. 356, datë 11.07.2024, i cili bën fjalë për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit z. {...}, për periudhën 2020-2022.

Konkretisht, lidhur me vlerësimin etike dhe profesionale, për kandidatin e vetëm u konstatua se me vendimin e Këshillit nr. 356, datë 11.07.2024, kandidati është vlerësuar për periudhën 2020-2022, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 396 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional” të miratuar me këtë vendim.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në kushtet kur në këtë procedurë të lëvizjes paralele ka mbetur vetëm një i kualifikuar, pra vetëm një kandidat dhe për rrjedhojë edhe në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve është vetëm një i

tillë, u vlerësua se nuk ka vend për ndjekjen e hapave të mëtejshme të kritereve dhe përparësive të përcaktuara si të tilla në Kreun VI, Seksioni C të Vendimit nr. 320/2020, në funksion të renditjes së kandidatëve.

Relatori në këtë rast përgatiti projektvendimin për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023.

Projektvendimi i renditjes, pasi siç thashë është kandidat i vetëm, është i strukturuar në tre pika. Sipas pikës së parë të projektvendimit, Këshillit i propozohet të miratojë renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: z. {...} renditet i pari dhe i vetmi në këtë procedurë.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Dhe së fundmi përcaktohet se ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Projektvendimi “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, u shqyrtua nga Komisioni dhe i paraqitet Këshillit më pas për miratim.

Për të vijuar më tej, duke qenë se z. {...} është kandidat i vetëm në procedurën e përzgjedhjes dhe të renditjes, Komisioni propozon në zbatim të pikës 111, të vendimit të Këshillit nr.320/2020, i propozon Këshillit projektvendimin për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës (ky është projektvendimi i dytë që unë po propozoj në Këshill), në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky projektvendim është i strukturuar në 3 pika.

E përfshimë në të njëjtin relacion pasi thamë që është i vetëm në garë, nuk ka kandidatë të tjerë dhe menjëherë ai është i vetëm dhe fitues. Kështu që, pas projektvendimit të renditjes parashtrijmë edhe projektvendimin e dytë që ka të bëjë me procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele të tij.

Pika e parë e projektvendimit bën fjalë për transferimin e z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pika e dytë e projektvendimit përcakton se efektet juridike fillojnë më datë, e kam lënë opsionale për ta diskutuar datën se kur do fillojë efektet juridike të këtij vendimi për lëvizjen paralele të z. {...}. E kam lënë opsionale sepse duhet të diskutojmë që ai ndodhet edhe në procedurën e transferimit të përkohshëm dhe lëvizja paralele me transferimin e përkohshëm duhet të koordinojnë datat, pra të mbarojë transferimi i përkohshëm dhe pastaj të fillojnë efektet e transferimit në procedurën e lëvizjes paralele. Është për t'u diskutuar. Ne do ngremë propozimet tona. Unë propozoj datën 1 për shembull. Datën 1 gusht e propozoj si datë për transferim në procedurën e lëvizjes paralele sepse gjyqtari nuk ka dosje, asnjë lloj veprimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, sepse në transferim të përkohshëm ai vazhdon funksionet në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Kështu që efektet juridike mendojmë t'i japim në një kohë sa më të shkurtër për sa kohë ai ka dosjet në dorë. Themi, propozojmë datën 1 sepse ai është në transferim të përkohshëm dhe do propozojmë datën 31 si datë të fundit të afatit të mbarimit të transferimit të përkohshëm, pra mbaron më datë 31 dhe me datë 1 fillon efektet transferimin në procedurën e lëvizjes paralele.

Kështu që, meqenëse jemi tek projektvendimi i dytë që bën fjalë për transferimin në procedurën e lëvizjes paralele, pra transferimin përfundimtar të tij, propozoj datën 1, 1 gusht 2024.

Për të vijuar më tej, lexoj edhe vijimin e relacionit.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet zotit {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit 115/2016, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë. Pra të njoftohen të dy gjykatat dhe vetë

156

kandidati për transferimin nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe efektet se kur fillon ky transferim, me qëllim që gjykatat dhe ai të marrin masat për të vijuar punën si gjyqtar tashmë i transferuar në procedurën e lëvizjes paralele.

Së fundmi, në projektvendim përcaktohet edhe hyrja në fuqi e tij e cila hyn menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për të vijuar më tej, në kushtet kur Këshilli me vendimin nr. 102, datë 29.02.2024, ka vendosur ndër të tjera: “Gjyqtarit {...}, aktualisht gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një periudhë deri në 13.03.2025.”, ne konsiderojmë se është vendi që Këshilli të vendosë për ndërprerjen e transferimit sipas vendimit të sipërcituar.

S’ka nevojë të zgjatem shumë për ndërprerjen e transferimit sepse bëhet fjalë për të njëjtën gjykatë ku ai është transferuar përkohësisht ndërkohë që do transferohet përfundimisht nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele.

Projektvendimi i tretë në këtë rast për përfundimin përpara afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim për gjyqtarin z. {...} është i strukturuar në tre pika.

Në pikën e parë parashikohet përfundimi i afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim për gjyqtarin z. {...}.

Në pikën e dytë parashikohet “Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë, ne propozojmë datën 31, pra të fillojnë nesër. Nesër të jetë dita e fundit e funksioneve si gjyqtar i transferuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Ndërkohë që pasnesër i fillojnë funksionet si gjyqtar i transferuar në procedurën e lëvizjes paralele.

Pika e tretë, parashikohet se një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Faleminderit kolegë për vëmendjen.

Ilir Rusi: Keni diskutime për sa u parashtrua?

Nuk ka diskutime.

Atëherë, vazhdojmë me votimin e projektvendimit për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Z. {...}.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Keni diskutime në lidhje me projektvendimin “Për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e këtij projektvendimi.

158

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 01.08.2024.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Keni diskutime në lidhje me projektvendimin “Për përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim për gjyqtarin z. {...}”, sipas afatit të përditësuar dhe propozuar nga relatori përgjatë kësaj mbledhjeje?

Nuk keni diskutime.

Vazhdojmë në votimin e këtij projektvendimi.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim për gjyqtarin z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim, për gjyqtarin z. {...}.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 31.07.2024.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 26 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.07.2024)

Pika 27 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor” (datat 03.04.2024, 09.04.2024, 17.04.2024, 18.04.2024, 25.04.2024, 26.04.2024, 02.05.2024, 07.05.2024, 09.05.2024, 16.05.2024, 24.05.2024 dhe 29.05.2024).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:29 dhe mbaroi në orën 16:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)*</i> |
| 8. <i>Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Albens Tabaku* dhe z. *Bledar Bajri*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 2. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 4. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).**
- 5. Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice (në sallë).**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

27. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor” (datat 03.04.2024, 09.04.2024, 17.04.2024, 18.04.2024, 25.04.2024, 26.04.2024, 02.05.2024, 07.05.2024, 09.05.2024, 16.05.2024, 24.05.2024 dhe 29.05.2024).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 27 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, (datat 03.04.2024, 09.04.2024, 17.04.2024, 18.04.2024, 25.04.2024, 26.04.2024, 02.05.2024, 07.05.2024, 09.05.2024, 16.05.2024, 24.05.2024 dhe 29.05.2024).

Ju jeni njohur me përmbajtjen e tyre. Nëse keni diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk keni diskutime, kalojmë në votimin e tyre.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 03.04.2024, 09.04.2024, 17.04.2024, 18.04.2024, 25.04.2024, 26.04.2024, 02.05.2024, 07.05.2024, 09.05.2024, 16.05.2024, 24.05.2024 dhe 29.05.2024.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 27 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 30.07.2024)

Pika 28 shtesë e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile shpallur me vendimin nr. 243, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:29 dhe mbaroi në orën 16:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)*</i> |
| 8. <i>Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

¹ Shih procesverbalin e pikes 16 ku dhe është miratuar shtimi si pikë në rendin e ditës.

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Albens Tabaku* dhe z. *Bledar Bajri*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
4. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës (prezent në një pjesë të mbledhjes).*
5. *Arben Lila, përfaqësues i projektit EU4Justice (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

28 shtesë. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile shpallur me vendimin nr. 243, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke vlerësuar rrethanat objektive, vendosi që të shtojë edhe një pikë tjetër në rendin e kësaj mbledhjeje në lidhje me projektvendimin “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile shpallur me vendimin nr. 243, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Atëherë, shkurtimisht është relacioni i radhës që ka për objekt fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile shpallur me vendimin nr. 243, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nëpërmjet këtij projektvendimi ne sot i propozojmë Këshillit të përzgjedhë relatorin në procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë të kandidatëve që kandidojnë për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin nr. 243, datë 24.05.2023.

Ju bëj me dije se për këtë pozicion është kandidat i vetëm, vetëm zonja {...} për të cilën kanë përfunduar të gjitha procedurat, si procedurat e kualifikimit që u bënë ditën e djeshme më datë 29 korrik 2024, ashtu edhe dy vlerësimet e saj, njëri i përfunduar pak kohë më përpara dhe vlerësimi i dytë është përfunduar ditën e sotme.

Ndodhur në këto kushte, për sa kohë janë shteruar dhe përfunduar të gjitha procedurat që lidhen me kualifikimin dhe vlerësimin e saj, duke qenë edhe e vetme në pozicionin nr. 243, datë 24.05.2023, ne sot paraqesim relacionin e radhës që ka për objekt fillimin e procedurës së përzgjedhjes nëpërmjet të cilit të zgjidhet relatori dhe të vijojë procedurën më tej për renditjen dhe ngritjen në detyrë të kandidatës znj. {...}, e cila është kandidate e vetme për t'u ngritur në detyrë në pozicionin nr. 243.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, ftoj administratën në hedhjen e shortit.

Procedura e shortit si vijon:

Futen në enën e qelqit shiritat me emrat e relatorëve: z. Klodian Kurushi dhe z. Ridvan Hado.

Pas shortit, për kandidaten {...}, zgjidhet relator z. Klodian Kurushi.

Ilir Rusi: Atëherë, keni diskutime në lidhje me këtë projektvendim të përditësuar dhe me të dhënat të cilat rezultuan nga hedhja e shortit?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë kalojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile shpallur me vendimin nr. 243, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 243, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e z. Klodian Kurushi, si relator për këtë procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me shqyrtimin e kësaj pike të shtuar përgjatë kësaj mbledhjeje, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

167